

Edlira Ramaj

Adriana Keco

LIBËR PËR MËSUESIN

Qytetaria 4

BOTIME



BOTIME



Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Lindita PRELA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtja:

- **Plani mësimor vjetor**
- **Plani mësimor i ndarë sipas tremujorëve**
- **Modele të planifikimit ditor**

1. Hyrje në programin e qytetarisë

Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si e tillë, ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

Përmasën politike, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.

Përmasën ligjore, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.

Përmasën kulturore, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.

Përmasën shoqërore dhe ekonomike, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.

Përmasën evropiane, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.

Përmasën globale, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvlerësisë dhe solidaritetit global.

Programi lëndor rrjedh nga Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

Nxënësit për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.

Mësuesit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.

Prindërit për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit.

Hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2. Qëllimet e programit të lëndës së qytetarisë

Edukimi për qytetari demokratike synon:

- të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i lëndës së qytetarisë synon:

- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

3. Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen me kompetencat e tjera kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit.

Kompetenca qytetare

Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së qytetarisë nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i qytetarisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj. në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role,

debateve, prezantimeve etj. nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren. Programi i qytetarisë nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe

mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

4. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvlerësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësive qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvlerësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvlerësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvlerësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

5. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e qytetarisë duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

-Së pari, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.

-Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Historia dhe qytetaria

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj.

Qytetaria:

u jep aktualitet më të madh çështjeve, me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuara në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë, me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

Konceptet: Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.

Tema: Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.

Fusha kurrikulare: Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.

Përmasa vendore: historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

II. Gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria

1. Çfarë kanë të përbashkët gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj.

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë:

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë.
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç' mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Qytetaria:

- zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme;
- nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

6. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën shoqëria dhe mjedisi, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme, të kompetencave të tjera.

Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore , ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

- Nxënësi njeh dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.
- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut.
- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.
- Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.
- Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.
- Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.
- Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.
- Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë.
- Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.

- Nxënësi vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.
- Nxënësi zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe Evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to. Këto tematika janë:

- individët, grupet, shoqëria.
- kultura.
- prodhimi, shpërndarja dhe konsumi.
- pushteti, autoriteti, qeverisja.

7. Koha mësimore

Programi i lëndës së qytetarisë zhvillohet në 35 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

8. Udhëzime metodologjike

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimdhënies dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi i kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si i tillë ai nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dalë nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një

rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst lënda e qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruari reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht Brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, material didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

9. Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së qytetarisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *Dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të

veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënës; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në

përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;

- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive.*

Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballur me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

10. Mjedi i të nxënësve të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedi i nxënësve demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal. Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënësve formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime

që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës

për të shfrytëzuar TIK-un në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjesisë shoqërore;

11. Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënit të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënit, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të

përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit Brenda dhe jashtë shkollës.

12. Udhëzime për vlerësimin

Standardet e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend? dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një pjesë të rëndësishme në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, i aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë *edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë* përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë prirjet qytetare që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë;
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor;
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit;
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave;
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme;
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare, të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

13. Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e

nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj. Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet

përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

14. Sugjerime për përdorimin e TIK

Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.

Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për njohuri për shoqërinë.

Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.

Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software.

Përdorimi i simulimeve software.

Përdorimi i grafikëve software.

Paraqitja grafike e të dhënave.

PLANI MËSIMOR

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Qytetari

Shkalla: II

Klasa: 4

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe, që realizohen nëpërmjet lëndës së Qytetarisë gjatë shkallës së dytë

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Nxënësi:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)

Nxënësi:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie.
- zgjidh një problem(shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përgjedhjen e procedurave përkatëse.
- përgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).
- shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

Nxënësi:

- përgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formuleve në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të shprehurit.
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- ndërlikohet më tej dhe re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë

apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

Nxënësi:

- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

Nxënësi:

- vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

- prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi, në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), tregon detyrat dhe i diskuton me bashkëmoshatarët.
- tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

- përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas tematikave

Tematika 1: Individët, grupet, shoqëria

Unë dhe e mira e përbashkët

Nxënësi:

- identifikon veten si individ unik;
- identifikon aftësitë dhe shprehjet individuale;
- shpreh ndjenjat, dëshirat dhe gjendjen e tij;
- vë në dukje nevojat, ndjenja, dëshira, aftësi e interesa të të tjerëve dhe pranon se ato janë të rëndësishme për ta;
- pranon se plotësimi i nevojave të të tjerëve mund të jenë më i ngutshëm se i të tijave;
- dallon interesat e përbashkëta me shokët e shoqet e klasës;
- i vlerëson nevojat dhe interesat e përbashkëta si shprehje e të mirës së përbashkët.
- shpjegon se e mira e përbashkët kërkon dhe përkushtim të përbashkët;
- tregon përkushtim në respektimin e të mirës së përbashkët ose të nevojave të të tjerëve.
- merr përsipër përgjegjësi personale në emër të të mirës së përbashkët.

Të jemi përgjegjës

Nxënësi:

- identifikon interesa të përbashkëta ose të ndryshme në komunitetin ku bën pjesë;
- shpreh idenë e tij për rrugët më të mira për realizimin, si të interesave të përbashkëta ashtu edhe të atyre që janë të ndryshme duke zgjedhur si kriter bashkëjetesën paqësore të komunitetit;
- identifikon dukuri, qëndrime, sjellje, që dëmtojnë interesat e anëtarëve të komunitetit dhe të vetë komunitetit;
- sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtari të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit;
- zbaton në praktikë forma të caktuara të diskutimeve dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me nevojat e komunitetit në të cilin bën pjesë (shkollë, lagje etj.), të tilla si projekte etj.

Tematika 2: Kultura

Nxënësi:

- eksploron dhe shqyrton ngjashmëritë dhe ndryshimet në grupe të caktuara si familje, klasë, shkollë, shoqërinë në tërësi, duke iu referuar kulturave, nevojave të përbashkëta njëzore dhe interesave të tyre;
- jep shembuj se si përvojat e grupeve të caktuara mund të interpretohen ndryshe nga njëri me prejardhje dhe këndvështrime të ndryshme kulturore;
- shqyrton rrugët në të cilat:
 - gjuha shqipe,
 - tregimet, folklori, muzika,
 - krijimet

- i japin mundësi shprehjes së kulturës dhe ndikojnë në sjelljen e njerëzve dhe në jetën e tyre;
- krahason rrugët në të cilat njerëzit, në mënyra të ndryshme, mendojnë dhe ndajnë në mes tyre çështje të tilla si ajo e mjedisit fizik dhe kushteve sociale etj.;
- jep shembuj dhe shqyrton rëndësinë e unitetit kulturor dhe të larmisë kulturore brenda dhe në mes grupeve të ndryshme si shkollë, komunitet, popullsi autoktone etj.
- pranon ndryshimet shpirtërore ndërmjet shokëve të klasës.

Tematika 3: Pushteti, autoriteti, qeverisja

Rruga

Nxënësi:

- identifikon mjetet e komunikacionit, shenjat e trafikut dhe rregullat e qarkullimit rrugor;
- identifikon llojet e rrugëve dhe veçoritë e tyre.;
- dallon vendet e sigurta për të kaluar rrugën, si dhe bën krahasimin midis tyre;
- planifikon vende të sigurta për kalimet e përditshme ;
- tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor.

Kombi ynë

Nxënësi:

- dallon faktorët kryesorë për një sipërmarrje biznesi;
- identifikon disa tipa të organizimit të biznesit;
- përshkruan burimet, veçanërisht burimet njerëzore dhe burimet kapitale;
- diskuton për teknologjinë si burim kapital për të cilën kanë nevojë pothuajse të gjitha bizneset;
- krijon një reklamë;
- përkufizon rrallësinë (pamjaftueshmërinë) dhe koston oportune;
- identifikon aftësitë që mbështesin kërkesat, gjithnjë në rritje, të vendeve të punës;
- analizon aftësitë e tij dhe sheh si ato përshatën në një vend pune të caktuar.
- identifikon punë ose profesione që janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe grupimet e aftësive që nevojiten për to;
- krijon një përmbledhje të thjeshtë;
- përshkruan specializimet dhe konkurrencën në biznes;
- tregon nevojat globale të shumë bizneseve.

Shpërndarja e orëve sipas tremujorëve

Tematikat	shtator – dhjetor (12 orë)	dhjetor – mars (12 orë)	mars– qershor (11 orë)
Tematika 1: Unë dhe e mira e përbashkët (6 orë)	6 orë		
Tematika 2: Të jemi përgjegjës (8 orë)	6 orë	2 orë	
Tematika 3: Kultura (8 orë)		8 orë	
Tematika 3: Rruga (6 orë)		2 orë	4 orë
Tematika 4: Prodhimi, konsumi, shpërndarja (7 orë)			7 orë

Planifikimi vjetor

shtator – dhjetor 12 orë	dhjetor- mars 12 orë	mars – qershor 11 orë
1. Prijet dhe aftësitë e mia të veçanta		
2. Unë dhe të tjerët		
3. Interesat dhe synimet tona të përbashkëta		
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë		
5. Përkushtohem për të mirën e përbashkët		
6. Veprimtari praktike: Biblioteka e klasës		
7. Ne dhe komuniteti		
8. Ne jemi qytetarë		
9. Ne dhe të tjerët		
10. Interesat tona të përbashkëta		
11. Interesat e mia, interesat tona		
12. Përsëritje: Çfarë mësuam për përgjegjësitë?		
13	Bashkëjetesa paqësore	
14.	Veprimtari praktike: Pjesëmarrje aktive dhe e përgjegjshme	
15.	Kultura dhe elementet e saj	
16.	Kultura e popullit tonë	
17.	Traditat kulturore	
18.	Veprimtari praktike: Traditat tona	
19.	Larmia kulturore	
20.	Respektojmë kulturat	
21.	Toleranca ruan lidhjen mes kulturave	
22.	Përsëritje: Çfarë mësuam për kulturën?	
23.	Llojet e rrugës	
24.	Mjetet e komunikacionit	

25.		Përgjegjësitë e mia në rrugë
26.		Sinjalet e qarkullimit rrugor
27.		Veprimtari praktike: Vendet e sigurta për të kaluar
28.		Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën?
29.		Ideja ime
30.		Organizimi i biznesit
31.		Çfarë janë burimet?
32.		Punët fitohen me punë
33.		Një grupim aftësish
34.		Ndërlidhjet me botën
35.		Përsëritje: Çfarë mësuam për biznesin?

Planifikimi sipas tremujorëve

Tabela e planit tremujor (shtator - dhjetor)

Nr.	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi)	Burimet dhe materialet didaktike
1.	Unë dhe e mira e përbashkët 6 orë	Prirjet dhe aftësitë e mia të veçanta	Prirjet dhe dëshirat e mia	Lojë krijuese Lapsat në mes	Nxënësi: -identifikon veten si individ unik. -identifikon aftësitë dhe shprehjet individuale. -shpreh ndjenjat, dëshirat dhe gjendjen e tij.	albume
2.		Unë dhe të tjerët	Nevoja dhe dëshira të ndryshme	Vëzhgim - Diskutim Pesëvargësh	-dallon interesat e përbashkëta me shokët e shoqet e klasës.	libra për fëmijë
3.		Interesat dhe synimet tona të përbashkëta	Interesat e përbashkëta	Pyetja e ditës Përvijim i të menduarit		foto
4.		Të drejtat dhe përgjegjësitë	Çdo e drejtë ka një përgjegjësi.	Tryeza rrethore Shkrim i lire	-i vlerëson nevojat dhe interesat e përbashkëta si shprehje e të mirës së përbashkët.	skica
5.		Përkushtohem për të mirën e përbashkët	Punojmë vullnetarisht për më të mirën	Diskutim Lojë roli		filma mësimorë videokasete komputer aparate
6.		Veprimtari praktike: Biblioteka e klasës	Biblioteka e klasës sonë	Veprimtari në grupe Turi i galerisë	-shpjegon se e mira e përbashkët kërkon dhe përkushtim të përbashkët.	projektimi CD, DVD

7.	Të jemi përgjegjës 6 orë	Ne dhe komuniteti	Unë dhe të tjerët	Diskutim	-identifikon interesa të përbashkëta ose të ndryshme në komunitetin ku bën pjesë. -shpreh idenë e tij për rrugët më të mira për realizimin, si të interesave të përbashkëta ashtu edhe të atyre që janë të ndryshme duke zgjedhur si kriter bashkëjetesën paqësore të komunitetit. -identifikon dukuri, qëndrime, sjellje, që dëmtojnë interesat e anëtarëve të komunitetit dhe të vetë komunitetit -sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtari të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit.	albume libra për fëmijë foto skica filma mësimorë videokaseta kompjuter aparate projektime CD, DVD
8.		Ne jemi qytetarë	Qytetaria	Stuhi mendimi		
9.		Ne dhe të tjerët	Përgjegjësitë	Lojë Lojë me role		
10.		Interesat tona të përbashkëta	Shkolla ime	Dil rrotull- Fol rrotull		
11.		Interesat e mia, interesat tona	Konfliktet	Diagram i Venit		
12.		Përsëritje: Çfarë mësuam për përgjegjësitë?	Di të jem i përgjegjshëm	Shkrim i lirë		

Tremujori i dytë (dhjetor – mars)

Nr	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi)	Burimet dhe materialet didaktike
1.	Të jemi përgjegjës 2 orë	Bashkëjetesa paqësore	Toleranca	Pema e mendimit	-sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtarit të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit;	foto albume libra për fëmijë
2.		Veprimtari praktike: Pjesëmarrje aktive dhe e përgjegjshme	E mira e përbashkët	Diagram i Venit Lojë	-zbaton në praktikë forma të caktuara të diskutimeve dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me nevojat e komunitetit në të cilin bën pjesë	
3.	Kultura 8 orë	Kultura dhe elementet e saj	Kultura jonë	Pyetja sjell pyetjen Lojë roli	-eksploron dhe shqyrton ngjashmëritë dhe ndryshimet në grupe të caktuara si familje, klasë, shkollë, shoqërinë në tërësi;	Muzeume objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
4.		Kultura e popullit tonë	Kultura Shqiptare ndër breza.	Stuhi mendimi Shkrim i lirë. Diskutim për njohuritë paraprake.	-jep shembuj se si përvojat e grupeve të caktuara mund të interpretohen ndryshe nga njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore;	harta plane
5.		Traditat kulturore	Larmia kulturore e vendit tim.	Tryeza rrethore	-shqyrton rrugët në të cilat, gjuha shqipe,	piktura
6.		Veprimtari praktike: Traditat tona	Dita e traditës	Veprimtari në grupe Lojë roli Turi i galerisë	trëgimet, folklori, muzika, krijimet i japin mundësi shprehjes së kulturës dhe ndikojnë në sjelljen e njerëzve dhe në jetën e tyre;	dokumente historike
7.		Larmia kulturore	Jam i hapur ndaj kulturës tjetër	Marrëdhënie pyetje – përgjigje		gatime
8.		Respektujmë kulturat	Kultura të ndryshme, respektimi i tyre.	Shkrim i lirë	-krahason rrugët në të cilat njerëzit, në mënyra të ndryshme, mendojnë dhe ndajnë në mes tyre çështje të tilla si ajo e mjedisit fizik dhe kushteve sociale etj.;	punime artizanale të krahinave të ndryshme
9.		Toleranca ruan lidhjen mes kulturave	Jam tolerant/e	Diskutim me vargje të ritmizuara Shkrim i lirë Turi i galerisë		
10.		Përsëritje: Çfarë mësuam për kulturën?	Kultura të ndryshme paraqesin vlera			

11.	Rruga 2 orë	Llojet e rrugës	Lëvizja	Stuhi mendimi Diagram i Venit Di – Dua të di -Mësova	-identifikon mjetet e komunikacionit, shenjat e trafikut dhe rregullat e qarkullimit rrugor; -identifikon llojet e rrugëve dhe veçoritë e tyre.	foto albume
12.		Mjetet e komunikacionit	Lëvizja			

Tremujori i tretë (mars – qershor)

Nr	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi)	Burimet dhe materialet didaktike
1.	Rruga 4 orë	Përgjegjësitë e mia në rrugë	Shëndeti	Lojë Lapsat në mes Rishikim në dyshe Shkrim i lirë Di – Dua të di – Mësova Pema e mendimit	Nxënësi: -dallon vendet e sigurta për të kaluar rrugën, si dhe bën krahasimin midis tyre; -planifikon vende të sigurta për kalimet e përditshme ; -regon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor.	Harta Sinjale të qarkullimit rrugor foto
2.		Sinjalet e qarkullimit rrugor	Shëndeti			
3.		Veprimtari praktike: Vendet e sigurta për të kaluar	Lagjia jonë			
4.		Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën?	I sigurt në rrugë			
5	Kombi ynë 7 orë	Ideja ime	Reklama e idesë sime	Pyetja sjell pyetjen Gushëkuqi rrethor Shkrim i shpejtë Diskutim Lexo – diskuto Shkrim i lirë Stuhi mendimi Vija e vlerës Lojë Pema e mendimit	-dallon faktorët kryesorë për një sipërmarrje biznesi; -identifikon disa tipa të organizimit të biznesit; -përshkruan burimet, veçanërisht burimet njerëzore dhe burimet kapitale; -diskuton për teknologjinë si burim kapital për të cilën kanë nevojë pothuajse të gjitha bizneset; -krijon një reklamë; -identifikon aftësitë që mbështesin kërkesat, gjithnjë në rritje, të vendeve të punës; -analizon aftësitë e tij dhe sheh si ato përshatën në një vend pune të caktuar. -identifikon punë ose profesione që janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe grupimet e aftësive që nevojiten për to.	modele CV mjete shkrimi letër ngjitës
6		Organizimi i biznesit	Biznesi ynë			
7		Çfarë janë burimet?	Të krijoj një sipërmarrje	Lojë Pema e mendimit		
8		Punët fitohen me punë	Puna sjell mirëqenie			
9		Një grupim aftësish	Aftësitë e mia			
10		Ndërlidhjet me botën	Afër dhe larg			
11		Përsëritje: Çfarë mësuam për biznesin?	Biznesi ynë			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Prirjet dhe aftësitë e mia të veçanta		Situata e të nxënit: Prirjet dhe dëshirat e mia	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit: Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ përshkruan dëshirat;✚ identifikon aftësitë dhe sfidat individuale;✚ tregon për prirjet individuale;✚ vlerëson përkushtimin në realizimin e dëshirave.		Fjalët kyçe: i/e veçantë, sfidë, interesa, dëshira, prirje, përkushtim	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të fëmijëve në aktivitete ose kurse, lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë krijuese - Diskutim - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje - përgjigje - Lapsat në mes			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1: Nxënësit veprojnë në A4(fletë të palosura në formë fizarmonike) për të shkruar zinxhir njëri pas tjetrit prirjen ose pasionin më të madh (më të preferuar) në formën Gushëkuqi rrethor. Në fund të veprimtarisë 2-4’ bëhet leximi i tyre e veqohen dëshirat e përsëritura më shumë. Diskutohet rreth tyre. - Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë Hapi 2: - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 6 për dëshirat e tre fëmijëve të familjes. Diskutohet rreth tekstit			

përmes pyetjeve: Si mendoni ju? Nxënësit tregojnë se të gjithë fëmijët kanë dëshirat e aftësitë e tyre të ndryshme.

Hapi 3: Nxënësit komentojnë figurat dhe tregojnë për ngjashmëritë dhe ndryshimet që kanë me fëmijët e fotove.

Hapi 4: Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është e rëndësishme për të zhvilluar aftësitë në një fushë të caktuar?
- Cilat është sfida jonë e përhershme?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Për plotësimin e rubrikës: *Plotëso*, nxënësit do të punojnë individualisht për plotësimin e rubrikave për parapëlqimet dhe dëshirat. Ata sjellin shembuj se si janë përfshirë në aktivitete të ndryshme sipas dëshirave individuale, të prindërve dhe aftësive përkatëse.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit vendosen me grupe dhe tregojnë për pasionet e tyre si dhe sfidat që i duhet për të kaluar për realizimin e tyre. P.sh *Pasioni për sportin dhe puna e stërvitja pa fund e bëri Mesin një futbollist profesionist dhe figurë të shquar në mbarë botën.* Ose mund të vepohet me lojën: “ Më pëlqen të bëhem...”me metodën lapsat në mes. Pra pasioni lidhet me dëshirën për diçka të bukur dhe realizimin me shumë punë në realitet.

Komentohej fjalja: *Secili nga ne duhet të punojë për të realizuar dëshirat dhe për të ndjekur pasionet e veta.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Përshkruan dëshirat
- ✓ Identifikon aftësitë dhe sfidat individuale
- ✓ Tregon për prirjet individuale
- ✓ Vlerëson përkushtimin në realizimin e dëshirave.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit bëjnë një shkrim të shkurtër për prirjet individuale dhe sfidat që duhen për të ndjekur pasionet e veta.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Unë dhe të tjerët		Situata e të nxënit: Nevoja dhe dëshira të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: nevoja, ndjenja, dëshira, plotësoj, i domosdoshëm.	

<ul style="list-style-type: none">- identifikon nevojat personale dhe të tjerëve;- kupton rëndësinë e nevojave, ndjenjave dhe interesave të të tjerëve;- argumenton plotësimin e nevojave sipas rëndësisë																
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A ₄ , foto , DVD me filma për fëmijë, sende si: çokollatë, banane, petulla, pelenë etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Edukim me të drejtat e fëmijëve															
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Vëzhgim - Diskutim - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje- përgjigje - Lojë roli - Pesëvargësh - Shpjegim i përparuar i shprehjes.																
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1: Nëse është e mundur nxënësve ju paraqitet një fragment nga filmi <i>Mondi dhe Diana</i>. https://www.youtube.com/watch?v=dzs8Qgw5xQ4. Diskutohet rreth dëshirës së fëmijëve për të mbajtur një qen në shtëpi dhe problemet që sillte mbajtja e tij. Kjo ishte një dëshirë e domosdoshme apo tekë e fëmijëve? Diskutohet rreth tyre. Hapi 2: Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë.<ul style="list-style-type: none">▪ Veprimet në situatë Hapi 3: - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 8 për kërkesat e dy fëmijëve të familjes. Diskutohet rreth tekstit përmes pyetjeve të rubrikës: <i>Si mendoni ju?</i> Nxënësit tregojnë se të gjithë fëmijët kanë kërkesat e tyre që mund të jenë të njëjta por për nevoja të ndryshme si në rastin e këpucëve të Denit dhe Erës. Cila prej kërkesave duhet të plotësohet më parë? Pse? Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre duke komentuar edhe figurat. Hapi 4: Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxënësit tregojnë ndryshimet mes nevojave dhe dëshirave. Hapi 5: Kalohet në zhvillimin e veprimtarive të paraqitura në tekst për plotësimin e skemave për nevojat dhe dëshirat që ka gjithsecili e mund të jenë të ndryshme. Më pas kalohet në komentimin e tyre. Hapi 6: Nxënësit të ndarë në grupe veprojnë me lojë roli për dramatizimin e situatave të dhëna duke dhënë zgjidhjet e përshtatshme për plotësimin e nevojave e dëshirave sipas rëndësisë .▪ Demonstrim i rezultateve të arritura Hapi 7: Nxënësit veprojnë në A₄ për plotësimin e pesëvargëshit për fjalët:<table><thead><tr><th colspan="2">Nevojat</th><th>Dëshirat.</th></tr></thead><tbody><tr><td>të domosdoshme</td><td>të ndryshme</td><td>-----</td></tr><tr><td>plotësohen</td><td>duhen</td><td>kërkohen</td></tr><tr><td colspan="2">Nevojat janë të rëndësishme për jetën.</td><td>-----</td></tr><tr><td colspan="2">Të drejta</td><td>-----</td></tr></tbody></table>Komentohet fjalia përmbledhëse e faqes: <i>Plotësimi i nevojave të të tjerëve mund të jetë më i ngutshëm se plotësimi i dëshirave tona .</i>		Nevojat		Dëshirat.	të domosdoshme	të ndryshme	-----	plotësohen	duhen	kërkohen	Nevojat janë të rëndësishme për jetën.		-----	Të drejta		-----
Nevojat		Dëshirat.														
të domosdoshme	të ndryshme	-----														
plotësohen	duhen	kërkohen														
Nevojat janë të rëndësishme për jetën.		-----														
Të drejta		-----														
Vlerësimi i situatës: Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✓ identifikon nevojat personale dhe të tjerëve;✓ kupton rëndësinë e nevojave, ndjenjave dhe interesave të të tjerëve;✓ argumenton plotësimin e nevojave sipas rëndësisë																
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit mund të paraqesin një listë me nevoja të tyre duke i renditur sipas rëndësisë.																

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Interesat dhe synimet tona të përbashkëta		Situata e të nxënit: Interesat e përbashkëta	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Vlerëson të drejtat e njeriut si një grup vlerash të përbashkëta kolektive për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe kohezionin shoqëror.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ liston lloje të ndryshme interesash;✚ tregon se interesat dhe synimet mund të jenë edhe të përbashkëta;✚ dallon interesat e përbashkëta mes shokëve të klasës;✚ argumenton mendimin për respektimin e të mirës së përbashkët.		Fjalët kyçe: interesa, synime, e mira, të përbashkëta,	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A4, A3, lapsa me ngjyra, foto të aktiviteteve të fëmijëve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve - Pyetja e ditës - Përvijim i të menduarit - Lojë krijuese - argëtuese - Punë në grup.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1: Iu paraqitet nxënëseve në dërrasë pyetja: Çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh? Nxënësit i shkruajnë synimet e tyre për profesionet e të ardhmes dhe tregojnë arsyet e zgjedhjes. Mund të paraqitet edhe pyetja: Cili prej tyre është profesioni më i rëndësishëm për shoqërinë dhe pse?. Pranohen të gjitha argumentet e nxënëseve. Hapi 2: Nëse është e mundur nxënësit mund të komentojnë edhe foto të sjella nga situata të mospërputhjes së interesave të fëmijëve në jetën e përditshme në familje, klasë komunitet. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë			

Hapi 3: Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 10 për interesat e fëmijëve për lojën e futbollit. Diskutohet rreth saj përmes pyetjeve tek rubrika: *Si mendoni ju?* Nxënësit tregojnë pse u mërzi Andi? Çfarë synonte ai? Po shokët? Si mund ta kishte zgjidhur ndryshe Andi situatën? Nxënësit mund të tregojnë edhe situata të ngjashme me to dhe të argumentojnë mendimin për zgjidhjen e tyre.

Hapi 4: Mësuesi/ja konsolidon njohuritë me nxënësit përmes karakteristikave të marrëdhënieve të mira në shoqëri. Sillen edhe shembuj konkretë. Iu drejtohen pyetje nxënësve për rolin e interesave vetjake dhe atyre të përbashkëta në jetën e përditshme.

Hapi 5: Nxënësit veprojnë në formën e lojës dil rrotull fol rrotull. Loja argëtuese zhvillohet me zbatimin e rregullave:

Së pari secili nxënës zgjedh kutizat që i përshtaten në interesat e listuara.

Së dyti iu kërkojnë shokëve të bankës ose të tjerëve të grupit që të plotësojnë me emrin e tyre kutizat që ju përshtaten.

Së treti nxënësit shkëmbejnë librat dhe zbulojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet me njëri - tjetrin.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6: Nxënësit të ndarë sipas grupeve të interesit të përzgjedhur në lojën e mësipërme krijojnë një poster ose fletëpalosje: Interesat tona dhe rregullat që duhen zbatuar nga të gjithë. (puna mund të vazhdohet edhe në shtëpi)

Hapi 7: Komentohet fjalja përmblledhëse: *Është mirë të përkushtohemi për respektimin e të mirës së përbashkët.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ liston lloje të ndryshme interesash;
- ✓ tregon se interesat dhe synimet mund të jenë edhe të përbashkëta;
- ✓ dallon interesat e përbashkëta mes shokëve të klasës;
- ✓ argumenton mendimin për respektimin e të mirës së përbashkët.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit të ndarë në grupe mund të përfundojnë punimin e posterit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Të drejtat dhe përgjegjësitë		Situata e të nxënës: Çdo e drejtë ka një përgjegjësi	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënës: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: (6)Vlerëson të drejtat e njeriut si një grup vlerash të përbashkëta kolektive për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe kohezionin shoqëror.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ liston disa përgjegjësi që zbaton në shkollë, familje, komunitet;✚ tregon se çdo e drejtë ka dhe përgjegjësi;		Fjalët kyçe: e drejtë, përgjegjësi, respektoj	

<ul style="list-style-type: none"> flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe grupeve ku bën pjesë argumenton mendimet për ndikimet që kanë përgjegjësitë në veprimet e individit 	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A ₄ ,	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Edukim me të drejtat e fëmijëve
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Tryeza rrethore - Punë me tekstin - Lojë roli - Shkrim i lirë.	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtari paraprake: <p>Hapi 1: Mësuesi/ja i vendos nxënësit në formë rrethi dhe iu paraqet atyre vargun me fletë të fotokopjuara me të drejtat si dhe shprehja. Lexohen dhe diskutohet rreth të drejtave duke ju shkruar pas përgjegjësitë përkatëse. Iu kërkohet që për □ do njëren prej tyre të shkruajnë një përgjegjësi në dërrasë ose fletë.</p> <div data-bbox="113 697 1258 909"> <p style="text-align: center;"><i>“Çdo e drejtë ka në themel një përgjegjësi”.</i></p> <pre> graph LR A([Të luaj]) --- B([Të kem familje]) B --- C([Të shkoj në shkollë]) C --- D([Të them mendimin tim]) E([Të ushqehem]) --- F([Të shpreh ndjenjat]) F --- G([Të jem i lirë]) </pre> </div> <p>Hapi 2: Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimet në situatë <p>Hapi 3: - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 12. Komentohen figurat dhe diskutohet rreth situatës që zhvillohet mes Deas dhe mamash së saj. Punohen pyetjet në rubrikën: <i>Si mendoni ju? Nxënësit tregojnë se përgjegjësia është diçka që duhet bërë me domosdo nga individit. Tregojnë edhe për të drejtat e fëmijëve si të rëndësishme duke i shoqëruar ato me përgjegjësitë përkatëse.</i></p> <p>Hapi 4: Mësuesi/ja konsolidon njohuritë me nxënësit përmes materialit të dhënë. Përpunohet përmes pyetjeve.</p> <p>Hapi 5: Kalohet në plotësimin e veprimtarive në grup për plotësimin e të drejtave dhe përgjegjësi në tabelë dhe diskutimin rreth tyre. Nëse premton koha nxënësit mund të dramatizojnë një situatë për të drejtën e shprehjes së mendimit të lirë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Demonstrim i rezultateve të arritura <p>Hapi 6: Nxënësit veprojnë të pavarur për përshkrimin e një situatë kur i kanë zbatuar përgjegjësitë. Kalohet në leximin dhe komentimin e disa prej shkrimeve .</p> <p>Komentohet fjalja: <i>Kemi përgjegjësinë të sigurohemi që të drejtat tona dhe të të tjerëve të respektohen.</i></p>	
<p>Vlerësimi i situatës:</p> <p>Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ liston disa përgjegjësi që zbaton në shkollë, familje, komunitet; ✓ tregon se çdo e drejtë ka dhe përgjegjësi; ✓ flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe grupeve ku bën pjesë ✓ argumenton mendimet për ndikimet që kanë përgjegjësitë në veprimet e individit liston disa përgjegjësi që zbaton në shkollë, familje, komunitet; 	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit punojnë me detyrën e faqes 13 për përshkrimin e të drejtave dhe përgjegjësi që duhen respektuar nga të gjithë pjesëtarët e familjes.</p>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përkushtohem për të mirën e përbashkët		Situata e të nxënit: Punojmë vullnetarisht për më të mirën	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: (6)Vlerëson të drejtat e njeriut si një grup vlerash të përbashkëta kolektive për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe kohezionin shoqëror.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon se e mira e përbashkët kërkon përkushtim;✚ ilustron shembuj nga përgjegjësitë për të mirën e përbashkët;✚ krahason interesat personale me ato të përbashkëta;✚ argumenton mendimin për rëndësinë e punës vullnetare për të mirën e përbashkët.		Fjalët kyçe: përgjegjësi, e mira e përbashkët	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të fëmijëve në vite, lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve <ul style="list-style-type: none">- Diskutim - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje- përgjigje – Lojë roli - Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1: Lexohet pjesa: MBOLLËN TË TJERËT, HA TI, MBILL TI, TË HANË TË TJERËT S. Frashëri			
<div>Një plak nëntëdhjetë vjeç po mbillte një rrënjë ulliri. Një mbret që po kalonte aty pranë, u çudit nga kjo punë dhe e pyet plakun:<ul style="list-style-type: none">– Kur ke shpresë të të japë pemë ky dru që po mbjell?– Pas tridhjetë vjetësh, – i tha plakun.– Po mos vallë ke shpresë ti të rrosh dhe tridhjetë vjet që të hash pemë nga ky? – i tha mbreti.– Jo, – iu përgjigj plakun, – po mbollën të tjerët, hëngra unë, tani mbjell unë të hanë të tjerët.</div>			
Diskutohet rreth mesazhit që përcjell pjesa e lexuar përmes pyetjeve të ndërtuara nga mësuesi.			

Hapi 2: Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3: Hapen librat, komentohen fotot dhe diskutohet rreth tyre përmes pyetjeve të rubrikës: *Si mendoni ju?*

Nxënësit tregojnë cila është përgjegjësia e nxënësve për mirëmbajtjen e mjedisit të përbashkët.

Hapi 4: Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve: A është e rëndësishme përfshirja e veprimtarisë të të gjitha brezave për realizimin e të mirës së përbashkët? Pse? Si ndikojnë ato në jetën e përditshme?

Hapi 5: Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Përfundime të mundshme mund të jenë:

Punë në grupe: Hapat e mundshëm Në fillim ndahemi në grupe

Më pas caktojmë detyrat dhe bëjmë gati materialet e punës.

Në vazhdim bashkëveprojmë me më të rriturit për realizimin e mbjelljes.

Si përfundim rregullojmë e pastrojmë ambientin përreth e caktojmë detyrat

për grupin që do të merret me mirëmbajtjen.

Plotëso:

Interesat e mia

Luaj futboll, tortë, film
vizatimor, lojëra elektronike,
xhinse të reja.

Interesat e përbashkëta

Ajër i pastër, gjelbërim, ujë i pijshëm,
mundësi punësimi, siguri rrugore, mjekim
cilësor.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6: Nxënësit veprojnë me shkrim të lirë për përdorimin në fjali të togfjalëshit: e mira e përbashkët. Kalohet në leximin e disave prej tyre.

Komentohet fjalia: *Ne mund të marrim përsipër përgjegjësi dhe të punojmë për të mirën e përbashkët të klasës, shkollës e komunitetit, në mënyrë që të gjithë të kemi një jetë më të shëndetshme e më të mirë.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- ✓ tregon se e mira e përbashkët kërkon përkushtim;
- ✓ ilustron shembuj nga përgjegjësitë për të mirën e përbashkët;
- ✓ krahason interesat personale me ato të përbashkëta;
- ✓ argumenton mendimin për rëndësinë e punës vullnetare për të mirën e përbashkët.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit me ndihmën e prindërve veprojnë për realizimin e një projekti për të mirën e përbashkët përmes punës vullnetare për pastrim, rregullim, shtim të gjelbërimit, krijim bibliotekash, ndërtimin e një këndi sportiv etj.

Shënim: Nxënësit porositen të përgatisin në shtëpi për orën e ardhshme disa skeda me karton si dhe renditjen e listës së librave të bibliotekës sipas rendit alfabetik nisur nga mbiemri i autorit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Biblioteka e klasës		Situata e të nxënit: Biblioteka e klasës sonë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi shoqëror.- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit: Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një aktiviteti.➤ Kompetenca për jetën: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët në bazë klase/shkolle.➤ Kompetenca digjitale: Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ liston disa të mira të përbashkëta;✚ tregon se e mira e përbashkët kërkon përkushtim;✚ bashkëvepron për ndërtimin e bibliotekës së klasës;✚ vlerëson respektimin e të mirës së përbashkët.		Fjalët kyçe: përkushtohem, nevoja, e përbashkët	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, skeda libri, libra të ndryshëm për fëmijë, vula, lapustila, DVD		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Vëzhgim - komentim - Veprimtari në grupe - Turi i galerisë			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1: Bëhet një vëzhgim i bibliotekës së klasës, së shkollës dhe fotove të bibliotekës kombëtare. Nëse është e mundur mund të paraqiten edhe filmime nga biblioteka të ndryshme brenda e jashtë vendit. Nxiten diskutimet rreth tyre duke vlerësuar e diskutuar për nevojat për përmirësim që ka biblioteka e klasës.Hapi 2: Nxënësit janë ndarë në grupe dhe kanë përgatitur mjetet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë. Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe me ndihmën e mësuesve, nxënësve të senatit të shkollës madje edhe prindër. Njihet nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë Hapi 3: Hapen librat dhe lexohet situata e faqes për dëshirën e fëmijëve për ngritjen e bibliotekës. Diskutohet edhe për kërkesat që duhen zbatuar për ngritjen apo përmirësimin e bibliotekës së klasës ku vetë nxënësit zhvillojnë mësim.Hapi 4: Nxënësit kanë përgatitur stendat për reklamimin e librave dhe skedat më parë në shtëpi me ndihmën e prindërve.			

Hapi 5. Punohet në grupe për sistemimin e librave sipas këshillave të paraqitura në libër. Nxënësit veprojnë në grupe për sistemimin e librave sipas kategorive dhe rendit alfabetik të mbiemrit të autorëve.

Hapi 6. Me ndihmën e më të rriturve plotësohen skedat dhe renditen ato në kutinë e skedarëve. Punohet sipas mundësisë edhe me një laptop për të bërë regjistrimin elektronik të librave. Mendohet edhe për vendosjen e një emri për bibliotekën.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 7. Nxënësit përcaktojnë detyrat për grupet e punës për mirëmbajtjen e bibliotekës. Mund të përzgjidhen edhe grupet e prindërve që mund të japin ndihmën e tyre në veprimtaritë në vazhdim për pasurimin e bibliotekës.

Komentohet fjalja: *Mirëmbajtja e librave tregon respekt e përkushtim ndaj të mirës së përbashkët.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- ✓ liston disa të mira të përbashkëta;
- ✓ tregon se e mira e përbashkët kërkon përkushtim;
- ✓ bashkëvepron për ndërtimin e bibliotekës së klasës;
- ✓ vlerëson respektimin e të mirës së përbashkët.


Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit me ndihmën e prindërve mund të përgatisin një vulë për bibliotekën e klasës si dhe mendojnë me ndihmën e prindërve për pasurimin e bibliotekës me libra të rinj.

Shënim: Kjo veprimtari mund të shoqërohet edhe me vizitën në bibliotekën e shkollës apo në një bibliotekë aty pranë ku nxënësit të kenë mundësi të njihen më saktë me veprimtaritë që duhen ndjekur për të ndërtuar dhe mirëmbajtur një bibliotekë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Ne dhe komuniteti		Situata e të nxënit: Unë dhe të tjerët	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ➤ tregon çfarë është një komunitet; ➤ shpjegon si ndryshon ai në varësi të situatës; ➤ identifikon interesa të përbashkëta ose të ndryshme në komunitetin ku bën pjesë. 	Fjalët kyçe: komunitet përgjegjësi vetjake interesa
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve për komunitetin, teksti mësimor, përralla “ Rrepa e madhe”, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi - Lexo – diskuto - Tryeza rrethore	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <p>Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të kujtojnë përrallën “ Rrepa e madhe”. Nëse nuk e dinë, tregohet përralla shkurtimisht: <i>Në kopshtin e gjyshit, mbiu një rrepë e madhe. Gjyshi donte ta shkulte, por nuk e shkulte dot. Thërriti gjyshen. Gjyshi dhe gjyshja e tërhoqën, tërhoqën, por rrepa nuk shkulej nga vendi. Atëherë gjyshja thërriti mbesën. Gjyshi, gjyshja dhe mbesa e tërhoqën, tërhoqën por rrepa nuk shkulej nga vendi. Mbesa thërriti qenin, qeni thërriti macen, por rrepa nuk shkulej nga vendi. Macja thërriti miun dhe më në fund, me ndihmën e miut, ata e shkulën rrepën më të madhe në kopshtin.</i> Nxënësit nxjerrin mesazhin e përrallës duke diskutuar së bashku. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Çfarë dini për komunitetin?</i> Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2’, i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë.</p> <p>Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë pa u komentuar.</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p>▪ Veprimet në situatë</p> <p>Hapi 3. Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin në hyrje dhe nënvizojnë çfarë nuk kuptojnë. Mësuesja ndihmon nxënësit të kuptojnë informacionin e dhënë duke drejtuar pyetjet për diskutim: -Cilat janë komunitetet që dalloni në këtë shembull? A mund të sillni shembuj të tjerë komunitetesh, bazuar në jetën tuaj të përditshme? Çfarë do t’u sugjeronit Borës dhe Anës?</p>	

<p>Hapi 4.Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është komuniteti? - Në cilat komunitete bëjmë pjesë? <p>Hapi 5.Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Përfundime të mundshme mund të jenë:</p> <p>Punë në grupe: Duke vepruar së bashku në komunitet, ne i kryejmë më mirë detyrat tona.</p> <p>Mendo: Në familje kemi interesa të përbashkëta dhe të ndryshme me njëri-tjetrin. Duke i njohur dhe respektuar ato ne shmangim çdo konflikt të mundshëm.</p> <p>Përfshihu në komunitet: Nxënësit sjellin shembuj se si janë përfshirë në një aktivitet të komunitetit duke ndjekur pyetjet ndihmëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Demonstrim i rezultateve të arritura</i> <p>Hapi 6 .Nxënësit vendosen në formë rrethore (të gjithë ose me grupe) dhe japin një argument në lidhje me pyetjen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë të mirash ka pjesëmarrja në një komunitet? <p>Nxënësit japin mendimin e tyre duke e ilustruar edhe me shembuj të thjeshtë nga jeta e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i situatës:</p> <p>Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ shpjegon kuptimin e fjalës komunitet; ➤ përshkruan se si ndryshon ai në varësi të situatës; ➤ identifikon interesat e përbashkëta ose të ndryshme në komunitetin ku bën pjesë.
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p>1.Listo disa nga komunitetet ku bën pjesë.</p> <p>2. Shpjego se çfarë mund të ndodhë në një komunitet ku anëtarët e tij nuk bashkëveprojnë.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Ne jemi qytetarë		Situata e të nxënit: Qytetaria	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të nxënit: Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.➤ Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:		Fjalët kyçe: qytetar i përgjegjshëm	

<ul style="list-style-type: none"> tregon çfarë do të thotë të jesh qytetar i një komuniteti; identifikon përgjegjësitë e tij në komunitete të ndryshme ku bën pjesë. 	tolerancë pranim
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fjalë të urta popullore mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Zhvillimi i qëndrueshëm Bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim, Të nxënit në bashkëpunim, Shkrim i lirë	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <p><i>Veprimtari paraprake: Hapi 1</i> Nxiten nxënësit të plotësojnë fjalinë “ <i>Të jesh qytetar i mirë do të thotë...</i> ” dhe ta shkruajnë në një fletë për 1-2’. Më pas lexojnë fjalinë e shkruar dhe mësuesja i shkruan në tabelë.</p> <p><i>Të jesh qytetar i mirë do të thotë:</i></p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p><i>Hapi 2.</i> Nxiten nxënësit të tregojnë te cila prej fjalive të shkruara në tabelë e gjejnë veten e tyre. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Veprimet në situatë</i> <p><i>Hapi 3.</i> Mësuesja nxit nxënësit të mendojnë rreth situatës së paraqitur në pjesën hyrëse duke e filluar vetë leximin e saj: “Edona dhe mami hipën në autobus për të shkuar te gjyshja. Në stacionin e radhës hipën disa persona të moshuar.”</p> <ul style="list-style-type: none"> Çfarë mendoni se do të ndodhë? Lexoni si vazhdon ngjarja. Çfarë mendoni për sjelljen e Edonës? Si mendoni se është ndierë mami i saj? Si do të vepronit ju po të ishit në vendin e Edonës? Pse? Vështroini fotot më poshtë. Çfarë po bëjnë fëmijët në secilën prej tyre? Çfarë kanë të përbashkët të gjitha fotot? <p><i>Hapi 4.</i> Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t’u përgjigjen pyetjeve: -Çfarë e dallon një qytetar të mirë? - Pse duhen njohur të drejtat dhe përgjegjësitë si qytetarë?</p> <p><i>Hapi 5.</i> Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.</p> <p>Punë në grupe: Nxënësit plotësojnë në diagram përgjegjësitë e tyre në familje, në shkollë dhe në komunitet. Nxiten të krahasojnë përgjegjësitë në familje me ato të shkollës dhe komunitetit.</p> <p>Rast studimi: Punohet në mënyrë individuale nga nxënësit dhe më pas diskutohet. Nëse qëndrimet e tyre janë të</p>	

ndryshme në mjedise të ndryshme, nxitet diskutimi i tyre duke i ndihmuar me pyetjen:

- Pse do të vepronit ndryshe?

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit shkruajnë mendimin e tyre rreth fjalës së urtë popullore “ Më mirë një punë e bukur, sesa një mijë fjalë të bukura”.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- shpjegon çfarë do të thotë të jesh qytetar i një komuniteti;
- identifikon përgjegjësitë e tij në komunitete të ndryshme ku bën pjesë;
- përdor fjalor të pasur dhe argumenton mendimet.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Listo disa nga përgjegjësitë e tua në familje.

Emri

1. Plotëso fjalitë me cilësitë e një qytetari të mirë.

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

Një qytetar i mirë

2. Trego një rast kur je treguar ti një qytetar i mirë.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Ne dhe të tjerët		Situata e të nxënit: Përgjegjësitë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi. Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon cilat janë sjellje të përgjegjshme;✚ identifikon sjellje, dukuri, qëndrime që dëmtojnë interesat e anëtarëve të komunitetit;✚ jep shembuj personalë ku ka treguar sjellje të përgjegjshme		Fjalët kyçe: dëmtoj interesat qëndrim i gabuar i përgjegjshëm	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Shkrim i shpejtë ,Lexo- diskuto , Shkrim i lirë			

Organizimi i orës së mësimit

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1

Organizohet një lojë e thjeshtë duke i ndarë nxënësit në dy skuadra. P.sh. Secila skuadër të shkruajë në 3' disa nga emrat qyteteve të Shqipërisë. Në fund shpallet skuadra fituese dhe tregojnë si e organizuan punën, si zbatoi secili përgjegjësitë e tij në skuadër.

Hapi 2. Nxënësit do të shkruajnë për 5' pa e shkëputur dorën nga fleta se si sillen ata kur janë në park.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve pa u ndalur te gabimet drejtshkrimore. Mësuesja shkruan disa prej sjelljeve të treguara nga nxënësit në tabelë.


Në park	Sjellje të përgjegjshme

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

▪ Veprimet në situatë

Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Si mendoni se janë ndier të moshuarit gjatë ndeshjes së futbollit të shokëve?
- Po fëmijët më të vegjël? Cilat interesa të tjera u dëmtuan? Pse?
- Cilat janë interesat e shokëve?
- Ç'mund të kishin bërë ata?
- Si mund të ishin treguar më të përgjegjshëm?
- Krahasoni sjelljen tuaj në park me atë të Andit dhe shokëve të tij:



Hapi 4. Lexohet informacioni përmblidhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë duhet të bëjmë që të jemi të përgjegjshëm?
- Pse duhet të jemi të përgjegjshëm?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Raste studimi:

a)- Pse mendoni se sjellja e Edit është e gabuar? Cilat interesa cenohen? Çfarë duhet të bëjë Edi për ta ndrequr sjelljen?

Përfundimi: Ne duhet të mbajmë përgjegjësi kur bëjmë gabim.

b) - A jeni sjellë ndonjëherë si Alba? Pse mendoni se është e gabuar? Cilat interesa cenohen?

Përfundimi: Kur nuk tregohemi të përgjegjshëm, dëmtohen interesat më të mëdha.

c) - Mendoni se sjellja e Edonës është e përshtatshme? Si mendoni se duhet të jetë ndier Roni kur ka kuptuar se Edona ia ka treguar sekretin dikujt tjetër?

Përfundimi: Kur nuk tregohemi të përgjegjshëm, humbasim besimin e të tjerëve.

Punë në grupe: Nxënësit të ndarë në grupe përgatitin një poster me përgjegjësitë e tyre në klasë dhe i ekspozojnë në një kënd të klasës.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit shkruajnë për një rast kur janë treguar të përgjegjshëm.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- shpjegon se cilat janë sjellje të përgjegjshme;
- identifikon sjellje, dukuri, qëndrime që dëmtojnë interesat e anëtarëve të komunitetit;
- jep shembuj personalë ku ka treguar sjellje të përgjegjshme.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj mendimin tënd në lidhje me fjalinë “*Të jesh i përgjegjshëm do të thotë të kujdesesh për të tjerët po aq sa për veten*”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Interesat tona të përbashkëta		Situata e të nxënit: Shkolla ime	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.➤ Kompetenca e të menduarit: Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon se njerëzit në një komunitet kanë interesa të përbashkëta;✚ identifikon rrugë të ndryshme për realizimin e interesave të përbashkëta.		Fjalët kyçe: interesa të përbashkëta, marrëdhënie dinamikë	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto të nxënësve nga aktivitete shkollore, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Zhvillimi i qëndrueshëm Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Dil rrotull- Fol rrotull ,Lexo- diskuto , Ditari dypjesësh			

Organizimi i orës së mësimit

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1

Nxiten nxënësit të tregojnë për veprimtari të ndryshme shkollore që kanë zhvilluar dhe prezantojnë fotot që kanë sjellë, ose mund të shfaqen me videoprojektor në formën e një montazhi me foto. Lihen të shprehin emocionet dhe mendimet e tyre.

Hapi 2. Nxënësit do të lëvizin në hapësirat boshe të klasës dhe do të bisedojnë me njëri-tjetrin rreth pyetjes që mësuesja shkruan në tabelë “Çfarë na bashkon me njëri-tjetrin në shkollë”?

Diskutohen idetë e tyre me gjithë klasën dhe mësuesja i shkruan në tabelë disa prej tyre.

Çfarë na bashkon me njëri-tjetrin në shkollë?	Dëshira për të mësuar
---	---

Njihën nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

▪ Veprimet në situatë

Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- A mund të gjeni interesa të tjera të përbashkëta në shkollën tuaj?
- Çfarë mund të bëni ju që ato të realizohen?
- Po mësuesja juaj?
- Sa kohë kaloni në javë me mësuesen tuaj?
- A e dini se çfarë përgjegjësish dhe detyrash të tjera ka ajo?

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbljedhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësve.

Plotëso: Emërtohen aktiviteti që paraqet secila prej figurave të dhëna. (balet, hipje në kalë, ngritje e balonës, kamping, patinazh, ecje, kërcim me litar, lojë me raketa, fotografim, këndim me kitarë, lojë shahu, shikim i një program televiziv, lojë me formuese(puzzle), zhytje në ujë, ngjitje në mal.)

Zgjidh përgjigjen: Nxënësit punojnë në dyshe. Ata qarkojnë figurat që tregojnë pasione të ngjashme me të tyre dhe tregojnë si mund t'i zhvillojnë më mirë ato (duke mësuar rreth tyre, duke i praktikuar, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, duke marrë ndihmë të specializuar, etj.).

Përshkruaj: Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të punojë me dy nga figurat e dhëna për të përshkruar interesat e përbashkëta të anëtarëve të komunitetit përkatës.

Në përfundim lexohen nga një përfaqësues i grupit dhe diskutohet.

▪ Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6. Nxënësit shkruajnë një pasion që kanë dhe tregojnë çfarë interesash të përbashkëta kanë me anëtarët e tjerë të grupit.

Pasioni im	Interesat e përbashkëta me të tjerët

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- tregon se njerëzit në një komunitet kanë interesa të përbashkëta;
- identifikon rrugë të ndryshme për realizimin e interesave të përbashkëta.
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj mendimin tënd në lidhje me fjalinë “*Interesat e përbashkëta bëjnë të mundur që të njohim më mirë veten dhe të tjerët*”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Interesat e mia, interesat tona		Situata e të nxënit: Konfliktet	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.➤ Kompetenca e të menduarit: Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon se njerëzit kanë interesa të ndryshme, që duhet të mbahen parasysh;✚ shpjegon se, nëse nuk realizohen, interesat e ndryshme mund të çojnë në mosmarrëveshje.		Fjalët kyçe: interesa të ndryshme konflikt komunikim respekt i ndërsjellë	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, etiketa me fjalët kyçe, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlarësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Lexo- diskuto , Lojë me role			

Organizimi i orës së mësimit

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1

Nxiten nxënësit të shkruajnë cili është një nga pasionet e tyre më të mëdha në një fletë dhe ta ngjitin në një tabak letre, të cilin mësuesja e ka titulluar “Pasionet tona”. Në përfundim, ekspozohet në një kënd të dukshëm të klasës. Nxiten nxënësit të venë re ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet pasioneve të njëri – tjetrit.

Hapi 2. Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një .p.sh.:

pasion	Diçka që i pëlqen a e tërheq shumë dikë, ndaj së cilës ai është shumë i dhënë.
interes	Vëmendje e kujdes i veçantë që tregojmë për dikë a për diçka që ka rëndësi ose që na pëlqen.
konflikt	Mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy njerëzve
komunikoj	Shkëmbej mendime me dikë; merrem vesh mirë me dike.

U shpërndahen nxënësve të ngatërruar dhe të kthyer përmby. Nxënësi i parë që gjen kuptimin e secilës fjalë, thotë “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

▪ Veprimet në situatë

Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- A mendoni se ka të drejtë Dritani? Për çfarë ka të drejtë ai?
- Përmendni disa nga komunitetet ku bën pjesë Dritani. Cilat janë disa nga interesat e përbashkëta që ka Dritani me anëtarët e tjerë të këtyre komuniteteve?
- A mendoni se ka të drejtë fqinja? Për çfarë ka të drejtë ajo?
- A mund të sugjeroni një zgjidhje që t’i kënaqë të dyja palët?
- A keni raste të ngjashme nga jeta juaj?

Hapi 4. Lexohet informacioni përmblendës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Si mund të arrijmë një marrëdhënie shumë të mirë në komunitetin ku ne jetojmë?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësve.

Krijo: Nxënësit kujtojnë një situatë në të cilën kanë patur interesa të tjera nga ato të anëtarëve të një grupi dhe e tregojnë duke përdorur skemën e dhënë (cili është problemi, kush u përfshi në ngjarje, çfarë ndodhi, ku dhe kur ndodhi, si u zgjidh).

Mendo: Nxënësit punojnë në dyshe. Ata japin mendimet e tyre rreth pyetjeve të dhëna:

- Cilat ishin interesat e përbashkëta?

- Cilat ishin interesat e ndryshme?
- Pse u krijua situata e konfliktit?
- Si u zgjidh ajo? Si mund të ishte zgjidhur ndryshe?

Në përfundim lexohen nga disa dyshe mendimet e shprehura.

- **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Lojë me role

Nxënësit organizohen në grupe. Secili grup inskenon një situatë konflikti të krijuar në klasë dhe mënyra si zgjidhet ky konflikt.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon se njerëzit kanë interesa të ndryshme, që duhet të mbahen parasysh;
- shpjegon se, nëse nuk realizohen, interesat e ndryshme mund të çojnë në mosmarrëveshje;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj mendimin tënd në lidhje me fjalinë “*Konfliktet duhet të zgjidhen nëpërmjet komunikimit dhe respektit të ndërsjellë*”.

Emri

Kujto një situatë në të cilën ke patur interesa të tjera nga ato të anëtarëve të një grupi. Përdor skemën e mëposhtme për ta treguar atë.

Ku ndodhi ngjarja?

.....

.....

.....

.....

Kush u përfshi në ngjarje?

.....

.....

.....

.....

Cili ishte sugjerimi yt?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Cili ishte problemi?

Cilat ishin sugjerimet e shokëve?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Çfarë do të bëje ndryshe për atë situatë?

.....

.....

.....

.....

.....

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi		Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për përgjegjësitë?			Situata e të nxënit: Di të jem i përgjegjshëm	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debate.➤ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur➤ Kompetenca personale: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon përgjegjësitë e tij dhe të të tjerëve në komunitet;✚ krahason përgjegjësitë e tij dhe ato të shokëve;✚ sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtarit të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit.			Fjalët kyçe: përgjegjësi, komunitet, tolerancë, mosmarrëveshje, respekt, i përgjegjshëm	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Pema e mendimit, Lexo- diskuto , Punë në grupe, Diagrami i Venit				
Organizimi i orës së mësimi				
Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Zhvillohet loja “ Bingo”. Mësuesja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një ,p.sh.:				
përgjegjësi		Ndjenjë e lartë që ka njeriu, i cili merr përsipër me vullnet të kryejë sa më mirë një punë, një detyrë të ngarkuar nga shoqëria etj		
komunitet		Grup njerëzish, që janë të lidhur e të bashkuar nga prejardhja, nga kushtet e jetesës, nga veçoritë kombëtare, nga interesa e qëllime të përbashkëta, etj.		
respekt		Nderimi që kemi për dikë duke u nisur nga moshja, nga meritat ose nga cilësitë e tij.		
mosmarrëveshje		Mospajtim a mospërputhje mendimesh, pikëpamjesh, qëllimesh, veprimesh etj. ndërmjet dy a më shumë njerëzve.		

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2.

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet nga disa çifte.

▪ Veprimet në situatë

Hapi 3. Nxënësit lexojnë situatën e paraqitur në tekst dhe përshkruajnë hapat e zgjidhjes së saj në mënyrë që të kënaqen të dy palët.

Hapi 4.

Punë në grupe: Kjo detyrë synon që t'i nxitë nxënësit të sugjerojnë detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtari të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit. Nxënësit organizohen në grupe dhe zgjedhin një nga situatat e tekstit. Mësuesja ndihmon me pyetjet:


- Si mendoni se po i plotësojnë përgjegjësitë ndaj vetes këta fëmijë?
- Po përgjegjësitë ndaj grupit?
- Si do të vepronit ju?

Nxënësit sjellin shembuj të ngjashëm nga jeta e përditshme në klasë, familje, etj.

▪ Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6. Diagram i Venit

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Ata krahasojnë përgjegjësitë e tyre me ato të shokëve:



Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- identifikon përgjegjësitë e tij dhe të tjerëve në komunitet;
- krahason përgjegjësitë e tij dhe ato të shokëve;
- sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtari të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Plotësoni një listë me përgjegjësitë tuaja në familje.

Emri

Plotëso.

Ana i pëlqen shumë kafshët dhe kishte kohë që i lutej prindërve t'i blinin një qenush. Prindërit ia blenë dhuratë për ditëlindje. Cilat janë përgjegjësitë e saj?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Erbliu dhe Genti janë shokë të ngushtë. Këtë dimër, Erblini u sëmur dhe do të mungonte disa ditë në shkollë. Çfarë i këshilloni Gentit të bëjë?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Këtë vit, Era është ulur në bankë me Jonën. Jona ka qenë me familjen për shumë vjet në emigracion dhe ka vështirësi me gjuhën shqipe. Çfarë mendoni se duhet të bëjë Era?

.....

.....

.....


.....

.....

.....

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Bashkëjetesa paqësore		Situata e të nxënit: Toleranca	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit: Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi.➤ Kompetenca e të nxënit: Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).➤ Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">☛ tregon raste të dukurive, ngjarjeve, qëndrimeve e sjelljeve pozitive;☛ sugjeron mënyra që ndihmojnë në ruajtjen e paqes në komunitet.		Fjalët kyçe: mosmarrëveshje sjellje ngjarje qëndrime dukuri	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Stuhi mendimi, Lexo- diskuto , Shkrim i lirë			
Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një veprimtari të thjeshtë: Të gjithë nxënësit formojnë një rreth të madh të lidhur për dore. Secili prej tyre do të ngrejë lart dorën e shokut që ndodhet në të djathtë të tij dhe do të tregojë çfarë sjellje pozitive vlerëson te ai. Mësuesja tregon kujdes t’u kërkojë nxënësve se do të flasin vetëm për sjellje pozitive. Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Çfarë dini për bashkëjetesën paqësore?</i> Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2’, i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë. Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë pa u komentuar.			
<div></div>			
Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.			

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Cilat janë komunitetet e përmendura në këtë shembull?
- Cila është arsyeja e mosmarrëveshjes?
- Cila mund të jetë një zgjidhje e mundshme?
- A ju ka ndodhur ndonjëherë diçka e ngjashme? Si keni vepruar?

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Si mund të arrihet bashkëjetesa paqësore në komunitetin ku ne jetojmë?
- Pse është e nevojshme ajo?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Punë në grupe: Nxënësit lexojnë të ndarë në grupe një situatë dhe tregojnë si mund të zgjidhet. Tërhiqet vëmendja e nxënësve në gjetjen e zgjidhjeve të kënaqshme për të dy palët.

Lojë me role: Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup do të gjejë sa më shumë argumente pse duhet të bëjnë atë zgjedhje që ata propozojnë. Mësuesja i rendit argumentet e nxënësve në tabelë:

<i>Vendi ku duam të shkojmë</i>	<i>Pse duhet të shkojmë?</i>
<i>Muzeu i Shkencave Natyrore</i>	<ul style="list-style-type: none"> • •
<i>Muzeun Historik Kombëtar</i>	<ul style="list-style-type: none"> • •

Në përfundim arrijnë në një zgjidhje të kënaqshme për të dy grupet.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë mendimet e tyre në lidhje me temën “Kur jemi tolerantë, shoqëria jonë është më e fortë.”

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon raste të dukurive, ngjarjeve, qëndrimeve e sjelljeve pozitive;
- sugjeron mënyra që ndihmojnë në ruajtjen e paqes në komunitet.;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Trego një rast kur ke ndihmuar shokët për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi		Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV				
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Pjesëmarrje aktive dhe e përgjegjshme			Situata e të nxënit: E mira e përbashkët					
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit: Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi.➤ Kompetenca e të nxënit: Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin➤ Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.								
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon shembuj të sjelljeve të përgjegjshme;✚ jep shembullin e përgjegjësisë ndaj së mirës së përbashkët në klasë, shkollë dhe komunitet;✚ merr pjesë në jetën publike në përputhje me nevojat e komunitetit ku bën pjesë.			Fjalët kyçe: sjellje e përgjegjshme përkujdesem e mira e përbashkët					
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Ditari dypjesësh, Lexo- diskuto , Ditari dypjesësh								
Organizimi i orës së mësimi								
Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me lojë” Tri të vërteta dhe një gënjeshtër”. Të gjithë nxënësit do të shkruajë për veten e tij tri të vërteta dhe një gënjeshtër (për shembull: nxehem shpejt, jam tolerant, flas me zë të lartë, ndihem mirë me shokët e mi. Secili prej tyre i lexon dhe shokët do të zbulojnë cila është gënjeshtër. Hapi 2. Nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale tabelën:								
<table><tr><td>Çfarë do të thotë përgjegjësi?</td></tr><tr><td>Të ...</td></tr><tr><td>Të ...</td></tr><tr><td>Të ...</td></tr></table>					Çfarë do të thotë përgjegjësi?	Të ...	Të ...	Të ...
Çfarë do të thotë përgjegjësi?								
Të ...								
Të ...								
Të ...								

Plotësohet një tabelë e përbashkët me mendimet e nxënësve nga mësuesja.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e petaleve të lules me përgjegjësitë e tyre në familje, klasë komunitet.

- Cilat përgjegjësi i keni të njëjta me shokun?
- Cilat i keni të ndryshme? Pse ndodh kjo?

Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Japin shembullin e një rasti kur mendojnë se sjellja e tyre ka qenë vendimtare për zgjidhjen e një situatë të tensionuar.

- Cila ishte e mira e përbashkët në këtë rast?
- Si veprime për ta arritur atë?

Nxënësit u referohen detyrave të shtëpisë që kanë patur një orë më parë.

Plotëso: Nxënësit shkruajnë tri sjellje të papërgjegjshme dhe shpjegojnë një nga pasojat e secilës.

Mund të plotësohet vetëm njëri rast dhe të tjerat jepen detyrë shtëpie, me qëllim që të mbetet kohë e mjaftueshme për rubrikën “Punë në grupe”.

Punë në grupe: Kjo detyrë synon që t’i nxitë nxënësit të marrin pjesë në një debat publik për përmirësimin e jetës në komunitet.

Nxënësit organizohen në grupe dhe zgjedhin një nga temat e mëposhtme (ose tema të tjera që ata mund t’i identifikojnë si të rëndësishme për komunitetin ku jetojnë):

- a) Hapësirat e gjelbra publike
- b) Pastërtia e mjedisit ku jetojmë
- c) Respekti ndaj të moshuarve

Nxiten të identifikojnë hapat që do të ndiqen, të ndajnë përgjegjësitë mes anëtarëve të grupit, të gjejnë formën me të cilën do të ushtrohen të drejtat e tyre për pjesëmarrje publike, e të tjera.

Në fund, paraqiten para klasës rezultatet e tyre në formën e një prezantimi.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Ditari dypjesësh

Nxënësit plotësojnë mendimet e tyre në tabelë:

<i>Shembull përgjegjësie</i>	<i>E mira e përbashkët</i>

Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- identifikon shembuj të sjelljeve të përgjegjshme;
- jep shembullin e përgjegjësisë ndaj së mirës së përbashkët në klasë, shkollë dhe komunitet;
- merr pjesë në jetën publike në përputhje me nevojat e komunitetit ku bën pjesë.




Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni ndihmën e prindërve për përmirësimin e projektit tuaj (rubrika “ Punë në grupe”)

Emri

Shkruaj një sjellje të papërgjegjshme. Shpjego një prej pasojave të saj.

(në familje, në shkollë, në komunitet)



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV^{ët}
Tema mësimore: Kultura dhe elementet e saj.		Situata e të nxënit: Kultura jonë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.<ul style="list-style-type: none">- Kompetenca e të nxënit:<ul style="list-style-type: none">- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.- Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të grupit shoqëror prej nga vjen.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerret pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ njeh kulturën.✚ identifikon elementët kulturorë si pjesë përbërëse të trashëgimisë kulturore.✚ identifikon ide, vlera e këndvështrime të ndryshme nga të tija.✚ dallon ndryshimet mes kulturave.✚ tregon për traditat, këngët, veshjet, vallet e krahinës nga vjen.		Fjalët kyçe: kulturë, elemente kulturore, mënyrë jetese, komunitet	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të veshjeve, gatimeve, punime artizanale të krahinave të ndryshme , lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim - Punë me tekstin - Pyetja sjell pyetjen - Lojë roli - Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. U lexohet nxënësve vjersha me vargje të ritmizuara:			

Tek antropologu kulturor shkova një herë
E botën me sytë e tyre e shikon

E pyeta: Çfarë do të thotë fjala kulturë
Këto janë elemente të kulturës- vetëm ca.

Më tha: “Gjërat që njerëzit e një grupi bashkë i
ndajnë, Ato tregojnë vlerat e grupit –
ç’tradita ka.

Mënyra si mendojnë dhe çfarë bëjnë”.

Më tha që elementët që e përbëjnë

Tregojnë atë që njerëzit mendojnë,

Kur i sheh nga afër vlerat i dallon,

Hapi 2. Mësuesja u argumenton nxënësve se si ndikon kultura në mënyrën e jetesës së një komuniteti.

Punohet edhe me diskutim për njohuritë paraprake për kulturën ku nxënësit gjejnë sa më shumë fjalë lidhur me termin.



Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 38 për vizitën e Vesës në shtëpinë e Erës. Diskutohet rreth saj përmes pyetjeve: *Si mendoni ju?* Nxënësve iu kërkohet të argumentojnë mendimet për pyetjet si dhe të tregojnë situata të ngjashme në familjet e tyre. Komentohen edhe fotot përkatëse duke përshkruar elementet e tyre.

Hapi 4. Lexohen dhe komentohen informacionet e faqes për kulturën dhe elementet e saj. Nxënësit mund të listojnë edhe elementë të ndryshëm kulturorë që njohin.

Hapi 5. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e tabelës për gjetjen e fjalëve që lidhen me kulturën. Në fund bëhet leximi dhe komentimi i tyre.

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe me rastin e studimit. Lexohet situata dhe vepkohet me pyetje - përgjigje.

Nxënësit përshkruajnë në A₄ disa nga elementët kulturorë që përdorin në festat familjare. Nëse premton koha nxënësit mund të dramatizojnë organizimin e një feste familjare duke bërë të dukshme elemente të veçanta të festave fetare që organizojnë me të afërmit.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 7. Mësuesja bën pyetje për njohuritë që u morën rreth kulturës dhe elementëve të saj. Më pas vazhdohet me plotësimin me shkrim të tabelës tregojë identitetin tënd. Lexohen disa prej tyre. Komentohet fjalja: *Kultura ndikon në mënyrën e jetesës së një komuniteti dhe të një shoqërie.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Njeh kulturën dhe elementët kulturorë si pjesë përbërëse të trashëgimisë kulturore.
- Identifikon ide, vlera e këndvështrime të ndryshme nga të tijat.
- Tregon për traditat, këngët, veshjet, gatimet, vallet e krahinës nga vjen.
- Dallon ndryshimet mes kulturave.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj një element kulturor të krahinës ku jeton, mund ta shoqërosh edhe me foto ose vizatim.

Antropolog – shkencëtar që studion jetën dhe kulturën njerëzore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV^{et}
Tema mësimore: Kultura e popullit tonë		Situata e të nxënit: Kultura Shqiptare ndër breza.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ njeh kulturën e popullit.✚ identifikon elementët kulturorë si pjesë përbërëse të trashëgimisë kulturore të një populli.✚ tregon për traditat, këngët, veshjet, vallet e krahinës nga vjen.✚ argumenton mendimet për rëndësinë e elementëve kulturorë.		Fjalët kyçe: kulturë, folklor, traditë, gjuhë, muzikë, artizanat, elemente kulturorë.	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të elementëve kulturorë të trashëguar brez pas brezi, libri: “Tregime të moçme Shqiptare”, vegla muzikore popullore, lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

- Diskutim - Stuhi mendimi - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje- përgjigje - Shkrim i lirë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

▪ **Veprimtari paraprake:**

Hapi 1. Nxënësit dëgjojnë në magnetofon ose shohin në iPad ose videoprojektor një nga këngët e polifonisë së Jugut. Nëse nuk ka mundësi dëgjohej një pjesë e regjistruar me fyell.

Hapi 2. Mësuesja drejton bisedën të nxitur prej saj. – Keni dëgjuar ndonjëherë këngë të tilla? Ku? Çfarë kanë të përbashkët? Di ndonjëri nga ju të këndojë këngë të tilla? Si ndikojnë ato në ditët e sotme? etj. Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënët që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3.- Hapen librat dhe komentohen figurat. Diskutohet rreth tyre përmes pyetjeve: Si mendoni ju? Nxënësit tregojnë se të gjitha figurat kanë elemente të veçantë të traditave popullore. Nëse nuk ju vjen në mend ju kujtohet që këto elementë kulturorë pasurohen brez pas brezi dhe bëhen të njohura për brezat në festivalet folklorike. (Festivali Folklorik i Gjirokastrës.) Disa nga përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Hapi 4. Lexohen dhe komentohen informacionet e faqes për kulturën dhe elementet e saj.

Hapi 5. Nxënësit punojnë në grupe duke diskutuar rreth legjendës: “Gjergj Elez Alia”. Renditin dhe argumentojnë mesazhet që përfaqëson ajo. P.sh **Ta duam dhe mbrojmë atdheun...**

Hapi 6. Nxënësit veprojnë të pavarur për të lidhur profesionistët me kulturën përkatëse.

P.sh Valltarë — kultura muzikore, rrobaqepës — kultura e veshjes, Notarë – kultura sportive, shkrimtarë, përkthyes – kultura gjuhësore.

Hapi 7. Nxënësit punojnë të pavarur për përshkrimin e një ose disa veglave popullore muzikore. Komentohen përshkrimet. (forma, materialet përbërës, zonat ku përdoret)

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 8. Nxënësit lexojnë 2-3 legjenda nga libri: “Tregime të moçme Shqiptare” ose ndonjë legjendë nga folklori dhe komentojnë mesazhet që përftohen prej tyre.

Komentohet fjalja: *Mbrojtja dhe promovimi i vlerave kulturore të krijuara në shekuj është përgjegjësi e të gjithëve.*

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- Njeh kulturën dhe elementët e kulturës popullore.
- Identifikon elementët kulturorë si pjesë përbërëse të trashëgimisë kulturore të një populli.
- Tregon për traditat, gjuhën, këngët, veshjet, gatimet, vallet e punimet artizanale që njeh.
- Shprehet qartë e me gjuhë të pasur për kulturën popullore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

1. Nxënësit do të përshkruajnë me ndihmën e prindërve një punim artizanal që kanë në familje.
2. Nxënësit do të krijojnë një album me foto të vendeve të ndryshme turistike që duhen vizituar në Shqipëri.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Traditat kulturore		Situata e të nxënit: Larmia kulturore e vendit tim.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit :<ul style="list-style-type: none">- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ liston disa nga traditat popullore që njeh.✚ tregon se si ndikojnë traditat kulturore në jetën tonë.✚ argumenton për ndikimin e traditës në pasurimin e kulturës popullore.		Fjalët kyçe: tradita, ndryshime kulturore, pasuri kulturore, grupe kulturore, folklor, gjuhë, muzikë, artizanat, .	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të ndryshme të qyteteve Gjirokastrë, Shkodër, Berat, Krujë ose kartolina, videoprojektor, lapsa, ngjyra uji.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Diskutim për njohuritë paraprake - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje - përgjigje - Tryeza rrethore			

Përshkrimi kontekstual i situatës:***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. U paraqiten nxënësve pamje nga qyteti i Gjirokastrës ose Beratit dhe ata komentojnë elementë të veçantë të tyre. (rrugët, ndërtesat, ushqimet e veçanta, veshjet...)Disa nga përgjigjet mund të shkruhen edhe në dërrasë. Sipas mundësive mund të ndiqet edhe një film dokumentar i paraqitur në videoprojektor.

Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjeve: Cilët elementë të traditës mund të përmendni? Mbasi nxënësit mendojnë për 2', i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 42 për veprimtarinë e nxënësve të shkollës. Diskutohet rreth saj përmes pyetjeve: Si mendoni ju? Nxënësit tregojnë cilin element të traditës popullore ju sjell ndër mend situata (rrugët me kalldrëm të qyteteve, gurgdhendësit) si dhe përshkruajnë situata të ngjashme që kanë përjetuar. Kujtohet që kjo teknikë sot përdoret edhe në ndërtim.

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve: Cilat janë disa nga elementët më të hershëm të kulturës sonë? Pse është e rëndësishme njohja dhe respektimi i tyre? Si ndikojnë në jetën tonë? Diskutohet edhe për figurat që paraqesin elementë të traditës si punime filigrani, qëndistari si dhe prodhime të enëve të bakrit.

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Lexohet fragmenti përshkrues i qytetit të Gjirokastrës, komentohen fjalët e vështira e sillen shembuj nga tradita në zejtari.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ose në grupe argumentojnë mendimin për pyetjen: Pse njerëzit po i kthehen sërish artit dhe traditës popullore nxitur edhe nga foto e informacioni i dhënë në libër(pazari i Krujës).

Komentohet fjalja: *Respektimi i traditave tregon kulturë.*

Vlerësimi i situatës:***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:***

- ✓ Liston tradita popullore Shqiptare.
- ✓ Tregon se si ndikojnë traditat kulturore në jetën tonë të përditshme.
- ✓ Argumenton për ndikimin e traditës në pasurimin e kulturës popullore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

1. Nxënësit mund të përgatisin me ndihmën e prindërve fletëpalosje ose reklama për punime të ndryshme artizanale.(përshkruajnë edhe mënyrën, vendin, procedurën e prodhimit)
2. Nxënësit do të përgatisin një album me informacione dhe kuriozitete kulturore për qytete të ndryshme të Shqipërisë (mund të ndahen edhe sipas prejardhjes).

Informacion për mësuesin.

Qyrqinj (gëzoftarë) ishte një veprimtari e hershme zejtare, që punohej me lëkurë të kafshëve të buta dhe të egra. Në fillim të shek. XX, përmenden 3 dyqane të kësaj zejtarie në Gjiilan.

Jepen udhëzime për nxënësit për orën pasardhëse pasi është veprimtari dhe kërkon parapërgatitje.

Ndarja në grupe; përzgjedhjet e materialeve; përcaktimin e detyrave...

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Traditat tona		Situata e të nxënit: Dita e traditës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<div>➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: -- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit. -- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.</div> <div>➤ Kompetenca e të menduarit: Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.</div> <div>➤ Kompetenca e të nxënit : -- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike. -- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti.</div> <div>➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).</div> <div>➤ Kompetenca qytetare: Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.</div>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <div><div>✚ identifikon kulturën dhe elementët përbërës si pjesë e trashëgimisë kulturore;</div><div>✚ tregon për tradita, këngë, valle, ushqime të krahinës nga vjen;</div><div>✚ përgatit postera, albume, filmime, dramatizime...me elementë të traditave dhe kulturës;</div><div>✚ vlerëson objekte të trashëgimisë kulturore pranë qendrës së tij të banimit.</div></div>		Fjalët kyçe: tradita, ndryshime kulturore, pasuri kulturore, grupe kulturore,	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit për veprimtaritë praktike , teksti i nxënësit, A4, harta e Shqipërisë, foto të kostumeve popullore ose veshje e krahinës, albume, kartolina, gërshtë, ngjitës etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Vëzhgim komentim - Veprimtari në grupe - Lojë rol - Turi i galerisë			

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- **Veprimtari paraprake:**

Hapi 1. Nëse është e mundur mund të ndiqet në videoprojektor një fragment nga emisioni Histori Shqiptare nga Alma Çupi <https://www.youtube.com/watch?v=VIFNSRGcZEK>. (për pazarin e vjetër të Krujës ose diçka tjetër sipas preferencave)

Hapi 2. Nxënësit janë ndarë në grupe dhe kanë përgatitur mjetet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë. Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe me ndihmën e prindërve ose gjyshërve.

- **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Nxënësit kanë përgatitur stendat me prodhime, kartolina, produkte të krahinave të ndryshme.

Hapi 4. Punohet për reklamimin e prodhimeve të ndryshme artizanale, grupe nxënësish mund të reklamojnë edhe produkte të ndryshme ushqimore.

Hapi 5. Një grup nxënësish paraqet paradën e veshjeve popullore sipas krahinave.

- **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 7. Grupi i përzgjedhur bën dramatizimin e dasmës (shkodrane, tiranase, ose përmetare) të përzgjedhur më parë me gjithë ritualet e veçanta të saj. Grupe të tjera kryejnë edhe kërcime të ndryshme popullore nën ritmet muzikore.

Hapi 8. Nga juria e prindërve dhe mësuesve përzgjidhet grupi me paraqitjen më të mirë.

(Mos harroni të fotografoni çastet më të bukura.)

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- ✓ Identifikon kulturën dhe elementët përbërës si pjesë e trashëgimisë kulturore.
- ✓ Bashkëpunon me shokët në grup.
- ✓ Tregon për tradita, këngë, valle, ushqime të krahinës nga vjen.
- ✓ Vlerëson objekte të trashëgimisë kulturore pranë qendrës së tij të banimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit mund të bëjnë një përshkrim të shkurtër të qytetit ku jeton ose dëshiron të jetojë me të gjithë elementet e veçanta kulturore. Mund të bëjnë edhe një paraqitje me vizatim ose në formën e një maketi.

Shënim:

Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe nën temën : Vizitë në muze, vende të ndryshme historike ose kulturore të qytetit/fshatit...

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Larmia kulturore		Situata e të nxënit: Jam i hapur ndaj kulturës tjetër.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: ➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : -- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit. -- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim ➤ Kompetenca e të menduarit: -- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. -- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore. ➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike. ➤ Kompetenca qytetare: Vlerëson të drejtat e njeriut si një grup vlerash të përbashkëta kolektive për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe kohezionin shoqëror.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: ✚ tregon për këndvështrime të ndryshme kulturore. ✚ identifikon kultura të ndryshme. ✚ tregon interes ndaj kulturës së tjetrit. ✚ vlerëson ekzistencën e larmisë kulturore në jetën tonë.		Fjalët kyçe: Larmi kulturore, anëtarë grupi, marrëdhënie mes grupesh	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të shtëpive të vjetra dhe disa të ditëve të sotme nga qytete ose kryeqytete, lapsa me ngjyra, fletë punë dore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë, Ndërvlerësia, Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim për njohuritë paraprake - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje – përgjigje - Shkrim i lirë - Punë në grup.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. Paraqitet në dërrasë fjalja dhe diskutohet rreth saj. <div>Ne jemi një popull i lashtë që dallohemi nga fqinjët tanë nga gjuha, zakonet...</div> Hapi 2. Nëse është e mundur paraqiten me foto ose videoprojektor pamje nga kryeqytetet e Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë e diskutohet për ngjashmëri e ndryshime mes tyre. Njihen nxënësit me temën e mësimin dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. ▪ Veprimet në situatë Hapi 3.- Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 46 për marrëdhëniet mes shokëve të klasës. Diskutohet rreth saj			

përmes pyetjeve. *Si mendoni ju?* Nxënësit tregojnë se të gjithë fëmijët kanë ndryshime mes tyre. Listojnë disa prej tyre. Kujtojnë se përdorimi i fjalëve dialektore janë një pasuri e kulturës gjuhësore. Komentohen edhe figurat. – Çfarë ndryshimesh të tjera mund të dalloni mes shokëve të klasës suaj?

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten nxënësit të diskutojnë rreth saj. A ndikojnë elementet kulturorë në marrëdhëniet mes anëtarëve të një grupi. Si?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Përfundime të mundshme mund të jenë:

Rast studimi: Tezja e Anit ka ndërthurur shumë bukur kulturën Italiane me atë Shqiptare.

Mendo dhe plotëso: ... do të visheshim njësoj, nuk do të kishim interes për kulturën e veshjes.

...do të kishim të njëjtën gjuhë, nuk do të kishim interes për kulturën gjuhësore.

...do të praktikonim të njëjtin sport, nuk do të kishim interes për kulturën sportive.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Nxënësit të ndarë në grupe përgatisin etiketa me forma e ngjyra të ndryshme me fjalët përshëndetëse dhe i ngjisin në tabakë duke përgatitur njëkohësisht edhe një stendë për klasën apo shkollën.

Komentohet fjalja: *Larmia kulturore dhe ajo e traditave janë pasuri dhe duhen respektuar.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:


- ✓ Identifikon kultura të ndryshme.
- ✓ Tregon interes ndaj kulturës së tjetrit.
- ✓ Vlerëson ekzistencën e larmisë kulturore në jetën tonë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit me ndihmën e prindërit do të shkruajnë në A4 fjalë të ndryshme dialektore së bashku me shpjegimin e tyre për të krijuar një minifjalor dialektor. Nxënësit mund të realizojnë një intervistë të improvizuar në dyshe: njëri në rolin e një gazetari të huaj që ka ardhur të bëjë një artikull për kulturën dhe tjetri do të tregojë për të veçantat e zonës që përfaqëson.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Respektojmë kulturat		Situata e të nxënit: Kultura të ndryshme, respektimi i tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ njeh kultura të ndryshme; ✚ tregon respekt për lloje të ndryshme kulturash; ✚ tregon interes për kultura të ndryshme; ✚ argumenton mendimin për ndikimin e kulturës në jetën e përditshme 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>respektojmë, kultura, ndryshime kulturore, keqkuptim, kuptoj kulturën tjetër</p>
<p>Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit për llojet e kulturave, teksti i nxënësit, A4, foto bardhë e zi të gjyshërve apo stërgjyshërve, kartolina me lloje veshjesh popullore, lapsa me ngjyra,</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p style="text-align: center;">Diskutim - Punë me tekstin - Marrëdhënie pyetje- përgjigje - Lojë roli - Shkrim i lirë.</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimtari paraprake: <p>Hapi 1. Mësuesi/ja paraqet para klasës fjalën “kulturë” dhe mirëpret nga nxënësit □do fjalë që lidhet me të.</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p>Hapi 2. Nxënësit iu paraqiten foto të vjetra bardhë e zi si dhe kartolina me lloje veshjesh popullore dhe nxitet diskutimi rreth tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimet në situatë <p>Hapi 3. - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 48 për festën në shtëpinë e Martinit. Diskutohet rreth saj përmes pyetjeve të rubrikës: <i>Si mendoni ju?</i> Nxënësit tregojnë se të gjithë fëmijët kanë dëshirë të festojnë 10-vjetorin dhe e organizojnë atë në mënyra të ndryshme. Nxitur edhe nga fotot nxënësit japin përgjigjet e argumentuara për mënyrën si është ndier Martini dhe ku gabuan shokët që qeshën me veshjen e flokët e gjyshes. Tregojnë edhe raste të ngjashme kur janë ndier jo mirë për ndryshimet kulturore mes bashkëmoshatarëve.</p> <p>Hapi 4. Lexohet informacioni përmbljedhës dhe nxiten t’u përgjigjen pyetjeve: - Si ka ndikuar kultura e grupit në mendimet dhe qëndrimet tuaja. – Si duhet të sillemi kur përballemi me kultura të ndryshme nga e jona? Mësuesi/ja vazhdon duke argumentuar faktin <u>që ashtu si kombet kanë kultura të ndryshme edhe qytetet, fshatrat, familjet kanë zakone e tradita të ndryshme.</u> Secila krahinë ka veshje, stile banimi e lloje ushqimi të ndryshme.</p> <p>Hapi 5. Zhvillohen veprimtaritë me tekstin e nxënësit. Në rubrikën Rast studimi nxënësit propozojnë zgjidhje me respekt e tolerancë për konfliktet. Përgjigjet shkruhen në tabelë e komentohen mes nxënësve.</p> <p>Hapi 6. Nxënësit të ndarë në grupe dramatizojnë me lojë roli situata problematike (nxitur nga situatat e librit ose reale) nga mungesa e respektit për kultura të ndryshme dhe propozojnë zgjidhjen e tyre me tolerancë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Demonstrim i rezultateve të arritura <p>Hapi 7. Nxënësit veprojnë të pavarur me shkrim të lirë për plotësimin e tabelës me traditat familjare. Lexohen disa prej tyre. Komentohet fjalja: <i>Respekti dhe toleranca ndaj kulturave të ndryshme janë sekretet e bashkëjetesës paqësore.</i></p>	
<p>Vlerësimi i situatës:</p>	

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ njeh kultura të ndryshme;
- ✓ tregon respekt për lloje të ndryshme kulturash;
- ✓ tregon interes për kultura të ndryshme;
- ✓ argumenton mendimin për ndikimin e kulturës në jetën e përditshme.

Detyrat dhe puna e pavarur:

1. Nxënësit përfundojnë tabelën me elementët e traditës familjare së bashku me prindërit .
2. Shkruajnë një ese me titull: Respektoj kulturat e ndryshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Toleranca ruan lidhjen mes kulturave		Situata e të nxënit: Jam tolerant/e	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare:<ul style="list-style-type: none">- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ njeh rolin e tolerancës në grupet shoqërore;✚ tregon se mirëkuptimi është pjesë e tolerancës;✚ argumenton se pranimi i mendimit ndryshe është pjesë e tolerancës;✚ vlerëson rolin e tolerancës për një bashkëjetesë paqësore.		Fjalët kyçe: tolerancë, mirëkuptim, bashkëpunim, respekt i ndërsjellë, bashkëjetesë paqësore	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte,	

teksti i nxënësit, A4, posteri i tolerancës,	Muzikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Diskutim me vargje të ritmizuara - Punë me tekstin - Lojë roli - Marrëdhënie pyetje- përgjigje - Shkrim i lirë.	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtari paraprake: <p>Hapi 1. Mësuesja u paraqet në dërrasë ose të shkruar në një flipchart vjershën për tolerancën. Lexohet disa herë dhe komentohen vargjet e saj. Sipas nivelit të klasës mund të rishkruhen vargje të ngjashme për to.</p>	
<p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi 2. - Hapen librat dhe lexohet situata e faqes 50. Mësuesi/ja nxit diskutimin përmes pyetjeve të rubrikës: <i>Si mendoni ju?</i> Nxënësit tregojnë se të gjithë fëmijët kanë të drejtat e tyre. Për të ndërtuar një marrëdhënie të mirë mes grupeve shoqërore është shumë e rëndësishme toleranca dhe pranimi i mendimit ndryshe. A është i drejtë veprimi i Andias ndaj vajzës rome? Po ju si do të reagonit në një situatë të tillë?</p> <p>Hapi 3. Nxënësit të ndarë në grupe mund të realizojnë situatën me role, si dhe të listojnë disa këshilla që duhen zbatuar nga të gjithë. Ato mund të shkruhen edhe në letër ose dërrasë.</p> <p>Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Disa përfundime të mundshme janë:</p> <p>Mendo: Disa nga fjalët e përshtatshme për tolerancën janë: dashuri, durim, mirësjellje, paqe, besnikëri, vetëkontrolli.</p> <p>Plotëso fjalitë: ...të jesh tolerant do të thotë të vlerësosh mendimin ndryshe.</p> <p>... toleranca është e nevojshme për <u>jetesën tonë</u>.</p> <p>... falje dhe të pranosh gabimet <u>janë sjellje tolerante</u>.</p> <p>Shpjegoj: Nxënësit argumentojnë thënien: “Trajtoji të tjerët si do të doje të të trajtonin ty”.</p> <ul style="list-style-type: none"> Demonstrim i rezultateve të arritura <p>Hapi 5. Nxënësit veprojnë me shkrim të lirë për shkrimin e një letre ndaj shokëve që të kanë bërë të ndihesh keq nga sjellja e tyre. (Si do të veproje po të ishe në vend të Jetës?)Shih modelin.</p> <p>Komentohet fjalja: Të jesh tolerant do të thotë të pranosh ndryshimet, edhe kur ato nuk të pëlqejnë.</p>	
<p>Vlerësimi i situatës:</p> <p>Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> njeh rolin e tolerancës në grupet shoqërore; 	

- tregon se mirëkuptimi është pjesë e tolerancës;
- argumenton se pranimi i mendimit ndryshe është pjesë e tolerancës;
- vlerëson rolin e tolerancës për një bashkëjetesë paqësore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësit do të shkruajnë disa mënyra si mund t'i kërkojnë ndjesë Jetës.

Nxënësit mund të shkruajnë një ese me thënien e faqes.

Shkruaj një letër për shokun shoqen që të ka lënduar me sjelljen e tij/saj:

Sot do të praktikoj tolerancën. Do të lë pa vëzhguar gabimet e të tjerëve.
Do të pranoj ndryshime që të tregoj që të gjithë jemi të ndryshëm në mendime e veprime. E na duhet punë për të arritur në bashkëveprim me mirëkuptime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për kulturën?		Situata e të nxënit: Kultura të ndryshme paraqesin vlera	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit			

shoqëror/komunitetit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> liston elementët e kulturës; dallon elementët e kulturës sonë mes të tjerave; tregon cilësi të njerëzve tolerantë; përshkruan elementët kulturorë; argumenton mendimin për situatat. 	Fjalët kyçe: kulturë, elemente kulturore, komunitet, tolerant, dialekt krahinor,
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A ₄ ,	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Lojë krijuese - Punë e pavarur - Shkrim i lirë - Lojë roli - Turi i galerisë	
Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1. Punohet kolektivisht për krijimin e disa vargjeve të ritmizuara për kulturën. Mund të ndihmohen nxënësit edhe nga mësuesja për realizimin saj.	
<div style="border: 2px solid black; border-radius: 15px; padding: 10px; text-align: center;"> <p>K KOMUNIKIM/ KOSTUME</p> <p>U URTËSI/ UNIK</p> <p>L LUMTURI/ LOJËRA</p> <p>T TRADITA</p> <p>U USHQIM</p> <p>R RITE</p> <p>A ARTIZANË/ ART/ ARGËTIM</p> </div>	
Hapi 2. Mësuesi/ja u sqaron nxënësve procedurën e plotësimit të rubrikave në tematikën përsëritje. Ju sugjerohet nxënësve të lexojnë me vëmendje kërkesat dhe të argumentojnë mendimin e tyre.	
<ul style="list-style-type: none"> Veprimet në situatë 	
Hapi 3. - Hapen librat e vepohet për plotësimin e rubrikave duke zbatuar njohuritë për kulturën dhe elementët e ndryshëm kulturorë.	
Në 1 nxënësit plotësojnë skemën me elementët e kulturës: <i>këngët, veshjet, gatimet, tregimet, punimet artizanale, gdhendja e gurit, veglat muzikore, gjuha, legjendat...</i>	
Në 2 nxënësit lidhin me hartën vetëm elementët e kulturës shqiptare: <i>qilimin, grupin Iso Polifonik, pupat kuq e zi, ballokumet, karrocën e drurit, veroret.</i>	
Në 3 nxënësit listojnë mbiemrat që mund t'i përshtaten fëmijëve tolerantë p.sh: <i>i dashur, i qetë, besnik, i mirë, i vetëkontrolluar, i ëmbël, i duruar...</i>	
Në 4 nxënësit përshkruajnë elementët kulturorë veshja, qilimi, shamitë e kërcimit, darja (vegla muzikore) karrigia e drurit, kërcimi popullor. Këshillohet argumentimi i mendimit me fjali i detajeve kulturore.	
Në 5 nxënësit përgjigjen me + si dhe shkrimin e një letre për të treguar si ndjehen në një ambient të ri.	
Hapi 4. Bëhet leximi i disa prej letrave që lidhen me empatinë e gjithsecilit prej nxënësve ose realizohet dramatizimi	

i një situatë të ngjashme.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 5. Nxënësit vizatojnë një element të veçantë kulturor (veshje popullore, qilima, enë, vegla muzikore, dhe e ekspozojnë në muret e klasës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:


- liston elementët e kulturës;
- dallon elementët e kulturës sonë mes të tjerave;
- tregon cilësi të njerëzve tolerantë;
- përshkruan elementët kulturorë;
- argumenton mendimin për situatat.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në stinën e verës organizohen shumë dasma. Tregoni për veshjet, ushqimet dhe organizimet e dasmave e festave në krahinën tuaj. Përmes tyre ruhen begatit dhe bukuria e krijimtarisë popullore. Mund ti paraqisni ato edhe përmes një vizatimi apo posteri me tematikë: *Dasmat Shqiptare në...*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Llojet e rrugës		Situata e të nxënës: Lëvizja	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.➤ Kompetenca e të menduarit: Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore➤ Kompetenca e të nxënës: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon çfarë është rruga;✚ identifikon lloje të ndryshme rrugësh;✚ dallon disa karakteristika të rrugëve.		Fjalët kyçe: rrugë, trotuar, autostradë, mbikalim, kalldrëm, rrugë ajrore, rrugë detare	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve për komunitetin, teksti mësimor, foto të ndryshme, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia	

	Zhvillimi i qëndrueshëm
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Lexo – diskuto, Shkrim i lirë, Diagrami i Venit	
Organizimi i orës së mësimi	
Përshkrimi kontekstual i situatës:	
Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të kujtojnë elementet që ka rruga dhe t'i shkruajnë në një fletë. Shkruhen mendimet e tyre në tabelë pa i komentuar: Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë pa u komentuar.	
	
Hapi 2. Paraqiten me videoprojektor foto rrugësh të ndryshme dhe lihen nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth tyre. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.	
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimet në situatë 	
Hapi 3. Vështrojnë rrugët e paraqitura në tekst dhe diskutojnë:	
<ul style="list-style-type: none"> - Cila prej rrugëve në fotografi ngjan me rrugët e vendbanimit tuaj? - A njihni lloje të tjera rrugësh? Flisni për to. - Ç'kanë të përbashkët me njëra - tjetrën rrugët që shikoni në fotografi ? - Nga se ndryshojnë? - Çfarë dallojmë në rrugët tokësore? (vijat e bardha, ...) - Pse rrugët janë të rëndësishme për njerëzit? 	
Hapi 4. Lexohet informacioni përmbljedhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:	
<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është rruga? Për se shërben ajo? - Si grupohen rrugët? - Si mund të jetë një rrugë tokësore? - Ku ndryshon autostrada nga rrugët e tjera tokësore? 	
Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.	
Plotëso: Disa lloje rrugësh mund të jenë: rrugë detare, rrugë ajrore, rrugë me një kalim, rrugë me dy kalime, rrugë e drejtë, rrugë malore, rrugë e asfaltuar, rrugë me kthesa, etj.	
Përkrahja: Nxënësit përshkruajnë rrugën e tyre nga shtëpia në shkollë duke treguar disa nga karakteristikat e saj, p.sh: <i>Rruga ku unë kaloj çdo ditë është një rrugë e drejtë dhe e asfaltuar. Ajo është me dy kalime dhe anash ka trotuare. Në të lëvizin shumë makina dhe biçikleta. Në rrugë ka vija të bardha dhe tabela të tjera që ndihmojnë qarkullimin. Në të dy anët e rrugës ka pemë të larta.</i>	
Në përfundim, nxënësit lexojnë përshkrimin e tyre dhe venë në dukje ngjashmëritë dhe ndryshimet me rrugët e përshkruara nga shokët.	
Punë në grup: Nxënësit tregojnë disa nga problematikat që venë re në rrugët ku kalojnë dhe sugjerojnë zgjidhje të tyre. Një përfaqësues i çdo grupi lexon detyrën, kurse mësuesja plotëson një tabelë të përbashkët:	

Probleme në rrugë	Si mund të zgjidhen?

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit krahasojnë rrugën e tyre me rrugën e vjetër të paraqitur në tekst.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon çfarë është rruga;
- identifikon lloje të ndryshme rrugësh;
- dallon disa karakteristika të rrugëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pyet prindërit dhe shpjego pse rrugët i afrojnë njerëzit me njëri-tjetrin dhe sjellin zhvillimin e shoqërisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Mjetet e komunikacionit		Situata e të nxënit: Lëvizja	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime➤ Kompetenca e të menduarit: Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon mjete të ndryshme komunikacioni;✚ shpjegon si kanë ndryshuar ato me kalimin e viteve.✚ krahason mjetet e para të udhëtimit me ato të sotmet.✚ tregon rolin e mjeteve të komunikacionit në zhvillimin e shoqërisë.		Fjalët kyçe: komunikacion, mjet komunikacioni biçikletë makina të së ardhmes	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto me mjete		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	

komunikacioni, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.	Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi Zhvillimi i qëndrueshëm						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Di - Dua të di - Mësova							
Organizimi i orës së mësimit							
Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Organizohet një lojë e thjeshtë ku nxënësit do të luajnë individualisht. Secili nxënës do të shkruajë për 2’ disa nga mjetet e komunikacionit që njih. Nuk duhet të përsëritet e njëjta fjalë dy herë. Fiton lojën nxënësi që shkruan më shumë fjalë. Hapi 2. Nxënësit njihen me teknikën që do të përdoret në këtë orë mësimi dhe plotësojnë kolonën “Di”, për ato që dinë rreth mjeteve të komunikacionit.							
<table><tr><td>Di</td><td>Dua të di</td><td>Mësova</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>		Di	Dua të di	Mësova			
Di	Dua të di	Mësova					
Mësuesja dëgjon përgjigjet për disa minuta. Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë. Plotësohet edhe kolona “Dua të di”. <ul style="list-style-type: none">Veprimet në situatë							
Hapi 3. Hapen librat dhe vështrojnë mjetet e komunikacionit të paraqitura në figurë. Nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">Si do t’i gruponit mjetet e komunikacionit? Shpjegoni pse.Çfarë dini për mjetet e para të komunikacionit? Si kanë ndryshuar ato me kalimin e viteve?Cili është mjeti juaj i preferuar? Pse?Përse jeta sot është kaq e varur prej mjeteve të komunikacionit?Ç’rëndësi kanë ato?							
Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t’u përgjigjen pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">Për se shërbejnë mjetet e komunikacionit?Si grupohen ato?Tregoni disa mjete të komunikacionit tokësor, ajror, detar.							
Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Plotëso: Plotësojnë emrat e mjeteve të komunikacioni sipas fjalëve ndihmëse që jepen (treni, helikopteri, anije, biçikletë). Mendo: Nxiten të diskutojnë rreth Ditës së Qytetit pa Makina, veprimtarive dhe rëndësisë që ka kjo ditë për mbrojtjen e mjedisit. Diskutojnë edhe rreth kuriozitetëve të dhëna për biçikletën dhe makinat e së ardhmes. Punë në grup: Nxënësit organizohen në grupe dhe secili grup punon me një nga temat e paraqitura në tekst. Grupi 1: Përparësitë dhe mangësitë që u sjellin njerëzve mjetet e komunikacionit. Grupi 2: Si e mendoni një qytet/fshat pa mjete komunikacioni? Grupi 3: Si e mendoni të ardhmen e mjeteve të komunikacionit? Nxiten të bëjnë pyetje ndaj grupeve dhe të japin mendimet e tyre pro ose kundër. <ul style="list-style-type: none">Demonstrim i rezultateve të arritura							
Hapi 6. Nxënësit plotësojnë kolonën e tretë të tabelës “Mësova”. Lexohen nga disa nxënës.							


Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- identifikon mjete të ndryshme komunikacioni;
- shpjegon si kanë ndryshuar ato me kalimin e viteve.
- krahason mjetet e para të udhëtimit me ato të sotmet.
- tregon rolin e mjeteve të komunikacionit në zhvillimin e shoqërisë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pyet prindërit se si kanë qenë mjetet e komunikacionit kur ata ishin fëmijë.

Emri

1. Plotëso skemën me mjetet që njeh.**2. Përshkruaj mjetin e komunikacionit që të pëlqen më shumë.**

.....

.....

.....

.....

.....

.....

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përgjegjësitë e mia në rrugë		Situata e të nxënit: Shëndeti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime. ➤ Kompetenca e të nxënit: Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. ➤ Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ✚ identifikon përgjegjësitë e tij në rrugë; ✚ argumenton domosdoshmërinë e përgjegjësisë së tij në rrugë; ✚ evidenton rreziqet që paraqet moszbatimi i rregullave. 		Fjalët kyçe: trotuar, vija të bardha, këmbësor, pasagjer	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lapsat në mes, Lexo – përmbledh në dyshe, Shkrim i lirë			
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të mendojnë për 1-2' se çfarë do të thotë të jesh i përgjegjshëm. Në grupe me nga 4, ata mendohen dhe vendosin lapsin në mes të tryezës kur kanë gati përgjigjet. Nxënësit që nuk kanë informacion vendosin lapsin duke thënë "Pas". Nxënësit i japin informacionin që dinë, mësuesja liston disa prej tyre. <i>Të jesh i përgjegjshëm do të thotë:</i>			

Hapi 2. Nxiten nxënësit të tregojnë se ku duhet të tregohen të përgjegjshëm.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Mësuesja nxit nxënësit të mendojnë rreth situatës së paraqitur në pjesën hyrëse duke e filluar vetë leximin e saj:

“Për të shkuar në shkollë, Erës dhe Drilonit u duhet të kalojnë gjatë një rruge ku qarkullojnë gjithmonë makina.”

- Çfarë përgjegjësish duhet të tregojnë dy fëmijët?

Më pas, nxënësit lexojnë vazhdimin e situatës dhe diskutojnë rreth saj:

- Kush kishte të drejtë, Era apo Driloni? Pse?
- Cilat janë disa nga rreziqet që paraqesin rrugët në këtë rast?
- Si mund t’i shmangin sa më shumë Era dhe Driloni?
- Tregoni dhe ju përvoja të ngjashme, nëse keni.

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës në dyshe me paragrafë: nxënësi 1 lexon paragrafin e parë “ si këmbësorë”, nxënësi 2 përmbledh dhe i drejton pyetje. Në paragrafët e tjerë (“Si përdorues të biçikletës ose patinave” dhe “ Si pasagjerë në makinë”) nxënësit ndërrojnë rolet.

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Plotëso: Nxënësit plotësojnë tabelën duke punuar në dyshe dhe pastaj diskutojnë gjetjet e tyre me gjithë klasën.

	Ç’ mund të ndodhë?	Shkaku	Pasojat	Mënjanimi i rrezikut
Rasti 1				
Rasti 2				
Rasti 3				
Rasti 4				

Punë në grup: Diskutojnë raste të tjera kur mund të jenë rrezikuar për shkak të mosplotësimit të përgjegjësive në rrugë.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit shkruajnë mendimin e tyre rreth fjalisë “Kur jemi të përgjegjshëm në rrugë, shpëtojmë jetën tonë dhe të tjerëve”.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:


- identifikon përgjegjësitet e tij në rrugë;
- argumenton domosdoshmërinë e përgjegjësive të tij në rrugë;
- evidenton rreziqet që paraqet moszbatimi i rregullave.

Detyrat dhe puna e pavarur:


Vëzhgo gjatë një jave rrugën më të afërt. Regjistro shkeljet që vëren. Në klasë, bëj një grafi k me shtylla për shkeljet që ke regjistruar. Bashkë me shokët/shoqet, diskutoni rreth tij.

Emri

1. Shkruaj rregullat që duhet të zbatohen për secilën figurë.



.....
.....



.....
.....



.....
.....



.....
.....

2. Shkruaj disa rregulla që zbaton ti në rrugë si këmbësor.

.....
.....
.....
.....
.....
.....

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV						
Tema mësimore: Sinjalet e qarkullimit rrugor		Situata e të nxënit: Shëndeti							
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime➤ Kompetenca e të menduarit: Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).									
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon sinjalet e qarkullimit në rrugë;✚ grupon sinjalistikën rrugore sipas llojeve;✚ shpjegon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;✚ argumenton rëndësinë e tyre.		Fjalët kyçe: sinjale, tabelë, standarde, ndalim, rrezik, tregues, panele plotësuese							
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto sinjale të qarkullimit rrugor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi Zhvillimi i qëndrueshëm							
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Di- Dua të di -Mësova									
Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Organizohet një lojë e thjeshtë: Para nxënësve paraqiten tabela me sinjale të qarkullimit rrugor dhe nxënësit shpjegojnë kuptimin e tyre. Hapi 2. Nxënësit plotësojnë kolonën “Di”, për ato që dinë rreth sinjaleve të qarkullimit rrugor.									
<table><tr><td>Di</td><td>Dua të di</td><td>Mësova</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				Di	Dua të di	Mësova			
Di	Dua të di	Mësova							
Mësuesja dëgjon përgjigjet për disa minuta. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Plotësohet edhe kolona “Dua të di”.									

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Hapen librat dhe lexojnë situatën hyrëse të shoqëruar me figurën përkatëse. Nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Cili mund të ketë qenë shkaku i aksidentit?
- Ç'rol luajnë tabelat me sinjalet e qarkullimit rrugor?
- Në ç'pjesë të rrugës vendosen ato? Pse?

Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Për se shërbejnë tabelat me sinjalet e qarkullimit rrugor?
- Si grupohen ato?
- Si janë sinjalet e rrezikut? Po sinjalet urdhëruese, treguese?
- Për se shërbejnë panelet plotësuese?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Plotëso: shënojnë numrin përkatës poshtë secilit sinjal të qarkullimit rrugor (3, 2, 5, 4, 1, 6).

Mendo: shënojnë G ose V përmbri çdo fjalie:

Këmbësorët mund të kalojnë kryqëzimet në mënyrë diagonale. G

Me biçikletë mund të lëvizim në çdo pjesë të rrugës. G

Kur udhëtojmë natën, duhet të vishemi me rroba të errëta. G

Respektimi i shenjave të qarkullimit rrugor mbron jetën tonë. V

Punë në grup: Tregojnë të përbashkëtat dhe ndryshimet që kanë shenjat e secilit rresht.

Rreshti i parë – E përbashkët :të dyja janë sinjale detyruese

Ndryshime: sinjali i parë i detyron këmbësorët të kalojnë kursi i dyti i urdhëron të ndalojnë.

Rreshti i dytë: E përbashkët : të dyja kanë figurën e biçikletës.

Ndryshime: sinjali i parë është sinjal ndalues kurse tjetri tregues.

Diskutojnë se cilën shenjë rrugore do të zgjidhnin për secilën nga këto foto dhe argumentojnë zgjedhjen e tyre (kalim këmbësorësh, kalim biçikletash, semaforë)

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit plotësojnë kolonën e tretë të tabelës “Mësova”.

Lexohen nga disa nxënës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- identifikon sinjalet e qarkullimit në rrugë;
- grupon sinjalistikën rrugore sipas llojeve;
- shpjegon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;
- argumenton rëndësinë e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Vizato ose fotografo tabela me sinjale të qarkullimit që shikon gjatë rrugës.

Emri


1. Plotëso duke vendosur numrat përkatës.

Sinjal rreziku _____


Sinjal tregues _____

Sinjal detyrues _____

Panel plotësues _____



1



2



3



4

2. Plotëso tabelën.

<i>Sinjalet e qarkullimit rrugor</i>	<i>Si janë?</i>	<i>Jep një shembull</i>
<i>Sinjalet e rrezikut</i>		
<i>Sinjalet e</i>		
<i>Sinjalet e</i>		
<i>Sinjalet e</i>		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Vendet e sigurta për të kaluar		Situata e të nxënit: Lagjja jonë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: ➤ <i>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:</i> Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.			

<p>➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>➤ Kompetenca e të nxënës: Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p> <p>➤ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).</p> <p>➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor; ✚ dallon në hartën e lagjes vendet e sigurta për të kaluar rrugën; ✚ planifikon vende të sigurta në hartën e lagjes për kalimet e përditshme; ✚ bashkëpunon me të tjerët në veprimtari. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Hartë, kalim i sigurt, sinjale, tabelë, standarde, ndalim, rrezik, tregues, panele plotësuese</p>
<p>Burimet e informacionit dhe mjete:</p> <p>Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, hartë e lagjes e printuar nga interneti, fletë me ngjyra, ngjitës, gërsërë, kunja dhëmbësh, plastelinë, makina lodër etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi</p> <p>Mjedisi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Diskutim, Punë në grupe, Turi i galerisë</p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <p>Veprimtari paraprake: Hapi 1</p> <p>Ora e mësimi fillon me përshkrimin e lagjes ku jetojnë. Nxënësit identifikojnë objektet më të rëndësishme të lagjes; specifikojnë ndryshimet që kanë ndodhur; përcaktojnë vendin më të pëlqyer, etj.</p> <p>Hapi 2.</p> <p>Kujtojnë çfarë mësuan për sinjalet e qarkullimit rrugor. Para nxënësve paraqiten tabela me sinjale të qarkullimit rrugor dhe nxënësit shpjegojnë kuptimin e tyre.</p> <p>Njihën nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënës që do të arrihen në këtë orë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimet në situatë <p>Hapi 3. Nxënësit nxiten të diskutojnë rreth pyetjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat nga sinjalet e qarkullimit rrugor keni vënë re në lagjen tuaj? - Cilat mendoni se mund të përmirësohen? <p>Hapi 4. Zhvillohet veprimtaria në tekstin e nxënësit hap pas hapi.</p> <p>Hapi i parë: Ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës. Secili grup do të përgatitë tabela me sinjale të qarkullimit rrugor</p> <p>Hapi i dytë: Përcaktojnë cilat nga sinjalet mund të jenë të domosdoshme për lagjen e tyre.</p> <p>Hapi i tretë: Presin letrat në formën e shenjave dhe i ngjitin në copa kartoni. Përdorin plastelinë dhe kunja dhëmbësh. I ngjitin në mënyrë të tillë që sinjalet të qëndrojnë vertikalisht.</p> <p>Hapi i katërt: I vendosin tabelat e përgatitura në hartën e lagjes duke përcaktuar më parë vendet më të sigurta për</p>	

kalimin e këmbësorëve.

Nxënësit mund të bëjnë një punë të përbashkët ose, në varësi të numrit të nxënësve të klasës, secili grup përgatit punën e vet.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe i ndihmon për çdo rast që mund të kenë nevojë.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6. Turi i galerisë

Nxënësit vëzhgojnë punët e grupeve dhe diskutojnë. Ata mund të drejtojnë pyetje dhe të argumentojnë punën e bërë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;
- dallon vendet e sigurta për të kaluar rrugën;
- bën krahasimin midis tyre;
- planifikon në hartën e lagjes vende të sigurta për kalimet e përditshme.
- bashkëpunon me të tjerët në veprimtari.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një ngjarje të shkurtër rreth figurës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën?		Situata e të nxënët: I sigurt në rrugë	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debate.➤ Kompetenca e të nxënët: Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.➤ Kompetenca personale: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;✚ shpjegon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;✚ identifikon mjete të ndryshme komunikacioni✚ identifikon përgjegjësitë e tij në rrugë.		Fjalët kyçe: Rrugë, rregull, përgjegjësi, mjet komunikacioni, kalim i sigurt, sinjale, tabelë, standarde, ndalim, rrezik, tregues, panele plotësuese.	

Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Mjedisi
---	--

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lojë, Pema e mendimit, Rishikim në dyshe, Shkrim i lirë

Organizimi i orës së mësimi

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1


Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një ,p.sh.:

rrugë	Është një hapësirë e caktuar mbi të cilën lëvizin njerëzit ose mjetet e
autostradë	Rrugë që ka dy ose më shumë korsi kalimi në secilin krah dhe ku kufiitë e shpejtësisë janë më të lartë se në rrugët e tiera.
komunikacion	Është tërësia e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në
sinjalet e rrezikut	Kanë formë trekëndëshi me kulm sipër. Ato kanë ngjyrë të kuqe, kurse simbolet janë të zeza.
sinjalet treguese	Kanë formë drejtkëndore ose katrore dhe janë me ngjyra të

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2.

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet nga disa çifte.

▪ ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Punohen ushtrimet në tekstin e nxënësit në mënyrë individuale dhe pastaj rishikohen në dyshe. Në përfundim diskutohen me gjithë klasën.

Detyra 1: sinjal tregues, sinjal rreziku, sinjal detyrues, sinjal urdhërues.

Detyra 2: Tërhiqet vëmendja e nxënësve në kujdesin që duhet të tregojnë kur kalojnë rrugën kur ajo nuk ka

semafor: në fillim duhet të ndalojnë; të shohin majtas, djathtas dhe përsëri majtas; të dëgjojnë dhe pastaj të kalojnë në anën tjetër.

Detyra 3: Kur rruga nuk ka trotuar për kalimin e këmbësorëve, duhet të ecim në krahun e majtë të saj, sepse kështu kemi mundësi të shikojmë makinat që na vijnë përballë dhe të mbrohemi.

Detyra 4: Kur udhëtojmë natën në rrugë, duhet të bëhemi të dukshëm duke veshur rroba të përshtatshme që të mos rrezikojmë.

Detyra 5: Përgjigjet e fjalëkryqit janë: Horizontalisht: 3- aeroplan; 4- autobus; 6- biçikleta; 7- varkë

Vertikalisht: 1 - anije; 2 - tren; 3- autoambulanca; 5 - kamion.

Detyra 6: Plotësojnë fjalitë me fjalët “duhet” ose “nuk duhet”: (Duhet të mbajmë kaskë mbrojtëse. Nuk duhet të flasim me celular kur ecim. Nuk duhet të luajmë në rrugë. Duhet të kalojmë me dritë jeshile. Duhet të kalojmë te vijat e bardha).

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Shkrim i lirë

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Ata shkruajnë rregulla të tjera që zbatohen në rrugë.

Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;
- shpjegon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;
- identifikon mjete të ndryshme komunikacioni;
- identifikon përgjegjësitë e tij në rrugë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani mendimin tuaj rreth fjalisë “*Siguria në rrugë është sfidë e përbashkët*”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV ^{et}
Tema mësimore: Ideja ime		Situata e të nxënit: Reklama e idesë sime.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.➤ Kompetenca e të nxënit :<ul style="list-style-type: none">- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon faktorët kryesorë për ngritjen e një biznesi sipërmarrës;✚ ushtron praktike për biznesin e lirë dhe sipërmarrjen;✚ krijon një reklamë.		Fjalët kyçe: Biznes i lirë, sipërmarrës, biznes, sipërmarrje, fitim, reklamë, mall, shërbim	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A ₄ , reklama me fletëpalosje ose pankarta, lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Ndërvlerësia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">- Diskutim- Stuhi mendimi- Punë me tekstin- Pyetja sjell pyetjen- Lojë roli- Punë në grup			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. U prezantohet nxënësve një fletëpalosje e një biznesi (fletushka reklame) dhe nxiten të diskutojnë përmes pyetjeve: - E dini ku ndodhet p.sh “Proper pizza” (ose një produkt tjetër)? I keni provuar ndonjëherë? Si janë? Do t’ua sugjeronit shokëve/shoqeve? Pse? Hapi 2. Mësuesja u paraqet nxënësve në dërrasë foto të bizneseve të ndryshme dhe iu kërkon të tregojnë me stuhi mendimi disa prej llojeve të bizneseve që njohin. <div><div>rrobaqepsi</div><div><div></div><div>Biznese</div><div></div></div><div>market</div></div> <p>Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimet në situatë			

Hapi 3. Hapen librat dhe lexohen e komentohen informacionet e faqes për biznesin e lirë, sipërmarrjen dhe reklamën me elementet përbërës. Nxënësit mund të listojnë edhe lloje të ndryshme biznesesh që njohin ose që kanë në familjet e tyre ose të afërmit e tyre.

Hapi 4. Komentohet foto e faqes për *Ideja ime* dhe nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale. Lexohen disa prej ideve.

Hapi 5. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e tabelës për konceptet. Në fund bëhet leximi dhe komentimi i tyre. ***Sipërmarrës quhet personi që fillon një biznes, aktivitet etj. (me qëllim fitimi).***

Sipërmarrje quhet biznesi i lirë ose aktivitet, panair...

Biznes i lirë quhet një sistem që u jep mundësi njerëzve ta zgjedhin lirisht biznesin/ aktivitetet e tyre.

Reklama është një mesazh ndikues që nxjerr në pah tiparet e veçanta të produktit ose shërbimit.

Fitimi është sasia e parave që mbetet pasi janë paguar të gjitha shpenzimet e biznesit.

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe me punimin e rubrikës: *Të zhvillojmë aftësitë e të menduarit*. Lexohet dhe vepkohet mes pyetje - përgjigjeve. Nxënësit mund të listojnë në A4 disa nga përgjigjet. Disa nga përgjigjet mund të jenë: ***Faktorët që ndikojnë për të hapur një biznes janë jo vetëm idetë por edhe shpenzimet, pajisjet, reklammat...***

Jo të gjithë mund të jenë sipërmarrës të mirë. Më të mirët janë ata që punojnë më shumë e janë të suksesshëm.

Nëse premtan koha nxënësit mund të dramatizojnë organizimin e një reklame për një mall të preferuar për fëmijë ose atë që kanë zgjedhur tek idetë.

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Mësuesja bën ndarjen e grupeve për zhvillimin e veprimtarisë praktike. Mund të zgjidhen edhe me short temat e biznesit dhe të mendohet fillimisht në klasë për argumentimin e përgjigjeve për pyetjet e dhëna. Komentohet fjalia: ***Ide të mira biznese të suksesshme.***

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ identifikon faktorët kryesorë për ngritjen e një biznesi sipërmarrës;
- ✓ ushtron biznesin e lirë dhe sipërmarrjen;
- ✓ krijon një reklamë të thjeshtë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit me ndihmën e prindërve realizojnë planin e kryerjes së shërbimit si dhe reklamën e mallit ose shërbimit. Këto punime nxënësit mund ti paraqesin në A2 sepse do të përdoren edhe në temat e ardhshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV ^{et}
Tema mësimore: Organizimi i biznesit		Situata e të nxënit: Biznesi ynë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënit :<ul style="list-style-type: none">- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.➤ Kompetenca për jetën: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ njih mënyrat si organizohet një biznes;✚ identifikon tri llojet e organizimit të biznesit;✚ merr pjesë në një proces të rritjes së një biznesi;✚ dallon disa nga përparësitë dhe mangësitë e çdo forme të organizimit të biznesit.		Fjalët kyçe: pronësi e vetme, ortakëri, aksionarë, ortakëri, aksione,	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, flipart, lapsa me ngjyra, etiketa me emërtime: pronar, jurist, llogaritar, menaxher, shofer, arkëtar		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Vëzhgim - Diskutim - Punë me tekstin – Punë në dyshe - Lojë roli - Pyetje - përgjigje			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. U kërkohet 2-3 nxënësve që të reklamojnë posterat e përgatitura në shtëpi për bizneset e zgjedhura prej tyre ose mund të ndiqet nga youtube një filmim për disa biznese të vogla e të mëdha që janë rritur në vite.(p.sh. COCA – COLA dhe EHË ...)Diskutohet rreth tyre. Mund të diskutohet edhe me një prind që punon si sipërmarrës, menaxher, drejtor. Hapi 2. Vendosen në muret e klasës foto të bizneseve të ndryshme (të vogla të mëdha).Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë			

Hapi 3. - Hapen librat dhe lexohen e komentohen informacionet e faqes për bizneset dhe mënyrat e organizimit të tyre me pronësi të vetme, ortakëri dhe korporata. Nxënësit mund të komentojnë edhe lloje të ndryshme biznesesh që njohin ose që janë pranë shkollës.

Hapi 4. Komentohet foto e faqes për bizneset *bulmet, berber, këpucar*. Nxënësit prezantojnë disa prej ideve për llojin e tyre. (pronësi e vetme apo ortakëri)

Hapi 5. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e tabelës për konceptet. Bëhet shkrimi i tyre nga një nxënës edhe në dërrasë ose në një flipchart. Kalohet në leximin dhe komentimin e tyre. Këto do të ndihmojnë në organizimin e biznesit.

Pronësia e vetme është lloj biznesi që funksionon nën drejtimin e një individi.

Ortakëria është bashkëpunimi i dy individëve si në sukses ashtu edhe në humbje.

Korporata është një lloj biznesi në pronësi të disa aksionarëve.

Aksion kapitali quhen përqindja e pasurisë që ka një individ në një biznes. Ato mund të shiten dhe blihen sipas mimeve të tregut.

Aksionerë quhen personat që janë në pronësi të aksioneve. (janë pronarë në përqindje të caktuar)

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe me lojën me role: *Të rritësh një biznes*. Lexohet dhe vepkohet përmes 10 hapave të dhëna në libër njëri pas tjetrit. Nxënësit mund të listojnë në A4 disa nga përgjigjet dhe të veprojnë praktikisht për prezantimin me lojë roli të rritjes së biznesit. Mund të shoqërohen edhe me veshje të përshtatshme për rolet edhe me kartela identifikimi të varura në qafë. Kujdes në komunikim me njëri-tjetrin.

Dr. Ina Hoxha
Menaxhere

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 7. Mësuesja bën pyetje për njohuritë që u morën si dhe situatat si do të vepronin në raste humbesh të parave, mosmarrëveshje mes pronarësh apo rritje të korporatave sipas rubrikës: *Të zhvillojmë atësitë e të menduarit*.

Komentohet fjalia: Menaxhim i suksesshëm, biznes i suksesshëm.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- njeh mënyrat si organizohet një biznes;
- identifikon tri llojet e organizimit të biznesit;
- merr pjesë në një proces të rritjes së një biznesi;
- dallon disa nga përparësitë dhe mangësitë e çdo forme të organizimit të biznesit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përcaktoni me ndihmën e më të rriturve hapat që duhet të ndiqni për rritjen e biznesit tuaj në rrethe të tjera që të arrihet në një korporatë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV ^{et}
Tema mësimore: Çfarë janë burimet?		Situata e të nxënit: Të krijoj një sipërmarrje	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:<ul style="list-style-type: none">- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit:<ul style="list-style-type: none">- Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore.➤ Kompetenca e të nxënit : Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">✚ liston lloje biznesesh dhe sipërmarrjesh:✚ përshkruan burimet, veçanërisht ato njerëzore dhe kapitale.✚ përkufizon pamjaftueshmërinë dhe koston oportune.✚ diskuton për teknologjinë, si një burim kapital i kërkuar nga shumica e bizneseve.		Fjalët kyçe: burime natyrore, burime njerëzore, burime kapitale, kosto oportune, pamjaftueshmëri, teknologji,	
Burimet: Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësit, teksti i nxënësit, A4, foto të bizneseve , lapsa me ngjyra,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Ndërvlerësia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: - Diskutim për njohuritë paraprake - Punë me tekstin - Pyetja sjell pyetjen - Punë në dyshe – Tryeza rrethore			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. U kërkohet nxënësve (zgjidhet një ose dy nxënës) të tregojnë për mënyrën si e rritën biznesin e tyre. Njëri nga nxënësit ose mësuesja liston në flipart burimet që i kanë ndihmuar për ta krijuar dhe rritur në vazhdimësi atë p.sh. Për prodhimin e reelit të qershive/ petullave/ byrekëve/kokoshka duhen: paratë, një njëri i afërm që është marrë me një biznes, oborri dhe prodhimet e pemëve, gjyshja dhe enët e saj, dyqani ku blen kavanoza, sheqer, miell...Hapi 2. Mësuesja u argumenton nxënësve se këto quhen burime të llojeve të ndryshme e tregon si ndikon bashkëveprimi i burimeve dhe shkëmbimi i ideve në mënyrën e mbarëvajtjes së një biznesi. Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë			

Hapi 3. - Hapen librat dhe lexohen informacionet teorike. Diskutohet rreth tyre. Nxënësve iu kërkohet të argumentojnë mendimet për rastet konkrete. Komentohen edhe fotot përkatëse duke përshkruar elementet e tyre.

Hapi 4. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e fjalive:

--**Burimet natyrore** janë burimet që njeriu i përfiton nga ambienti si mineralet, uji i lumenjve, burimet ujore, lënda drusore nga pyjet etj.

--**Burimet kapitale** janë burimet materiale si makineri e pajisje, burimet financiare ose kapitali financiar. (kursimet, dorëzani ose kredi bankare).

--**Burimet njerëzore** që është kapaciteti njerëzor përbëhet nga fuqia punëtore ose potenciali intelektual. Pamjaftueshmëria ndodh për mungesat që hasen në tre pikat e para.

--Një kosto oportune është një përfitim i mundshëm nga i cili hiqet dorë kur zgjidhjet një alternative mbi një tjetër.p.sh kemi për të shpenzuar 100 lekë. Zgjedhim të blejmë një libër 100 lekë apo të shkojmë në kinema me 100 lekë.

--**Teknologjia është burim kapital në dorë të njeriut.** Në fund bëhet leximi dhe komentimi i tyre.

Hapi 5. Nxënësit diskutojnë të vendosur në mënyrë rrethore për bizneset, burimet e tyre, kostot oportune dhe pamjaftueshmëritë sipas pyetësorit në rubrikën: *Të zhvillojmë aftësitë e të menduarit*. Për këtë bisedë mund të kërkohet edhe ndihma e një prindi biznesmen ose menaxher që e bën me të qartë përthithjen e informacionit përmes pyetje- përgjigjeve.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Mësuesja bën pyetje për njohuritë që u morën rreth burimeve dhe llojeve e rëndësisë së tyre. Komentohet fjalia: Që një sipërmarrje, aktivitet, biznes të jetë i suksesshëm duhet të mbështetet në ndërthurjen e burimeve natyrore, njerëzore dhe kapitale.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ liston lloje biznesesh dhe sipërmarrjesh:
- ✓ përshkruan burimet, veçanërisht ato njerëzore dhe kapitale.
- ✓ përkufizon pamjaftueshmërinë dhe koston oportune.
- ✓ diskuton për teknologjinë, si një burim kapital i kërkuar nga shumica e bizneseve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Kryej një intervistë me prindërit duke u nxitur nga pyetjet e rubrikës: *Të zhvillojmë shprehjet e qytetarisë*.

Shënim: Kjo temë mund të realizohet brenda mundësive edhe në një biznes të vogël pranë shkollës, për tu njohur më konkretisht me llojet e burimeve që përdoren për mbarëvajtjen e tij si dhe funksionimin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV ^{ët}
Tema mësimore: Punët fitohen me punë		Situata e të nxënës: Puna sjell mirëqenie	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: : Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit➤ Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem shoqëror dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.➤ Kompetenca e të nxënës :<ul style="list-style-type: none">- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.- Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të grupit shoqëror prej nga vjen.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmer pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.➤ Kompetenca digjitale: Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- liston burime të ndryshme për krijimin e shërbimeve;- identifikon aftësitë që mbështetin nevojat në rritje dhe shumë të kërkuara për vendin e punës;- analizon aftësitë personale në përputhje me kërkesat e një vendi pune.		Fjalët kyçe: aftësi,talente, kërkesa, oferta, inxhinieri, komunikim	
Burimet: Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, teksti i nxënësit, A4,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Muzikë,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësvë <ul style="list-style-type: none">- Gushëkuqi rrethor- Punë me tekstin- Punë në grupe- Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none">▪ Veprimtari paraprake: Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga: Duart tona punëto. Nxënësit tregojnë mesazhin që përcjell kënga. Hapi 2. U kërkohet nxënësvë që të veprojnë zinxhir për të shkruar profesionet që dëshirojnë të bëjnë kur të rriten (në një fletë që paloset si fizarmonikë). Përzgjidhen profesionet më të preferuara (të shkruara më shumë nga nxënësit pasi lexohen). Komentohen mendimet për to. Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënës që do të arrihen në këtë orë.▪ Veprimet në situatë Hapi 3. - Hapen librat dhe lexohen informacionet e faqes për aftësitë e individit dhe të mirat që sjell puna e vazhdueshme për plotësimin e kërkesave dhe ofertave. Komentohen edhe fotot përkatëse të faqes.			

Hapi 4. Nxënësit punojnë në dyshe për plotësimin e tabelës përplotësimin e fjalive.

Aftësitë janë talentet dhe zotësitë e një personi.

Kërkesa është nevoja për një produkt ose shërbim në një kohë të caktuar..

Oferta është tërësia e produkteve ose shërbimeve e gatshme për tu ofruar në një kohë të caktuar. Kërkesa dhe oferta janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën.

Inxhinieria është përdorimi i njohurive të matematikës dhe të metodave shkencave për të projektuar mallra e shërbime të reja në funksion të nevojave të shoqërisë.

Komunikimi është shkëmbimi me shkrim ose me gojë i informacioneve ndërmjet njerëzve.

Kur hyni në një dyqan për të blerë një akullorë, kjo do të thotë që keni **kërkesën** dhe **mundësinë** për ta blerë atë. Në fund bëhet leximi dhe komentimi i tyre.

Hapi 5. Nxënësit veprojnë në grupe për punimin e rubrikës: *Të zhvillojmë aftësitë e të menduarit*. Iu kërkohet nxënësve që të mbajnë shënim disa nga përgjigjet e mirë argumentuara dhe komunikohen para klasës. Nxiten nxënësit të shprehin të lirë edhe për informacionet që kanë për to nga jeta e përditshme.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Nxënësit shkruajnë të lirë në formën e një eseje me temë: “Punët fitohen me punë”. Lexohen 2-3 punime.

Komentohet fjalia: **Puna ndikon në mënyrën e jetesës së një komuniteti dhe të një shoqërie.**

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ liston burime të ndryshme për krijimin e shërbimeve;
- ✓ identifikon aftësitë që mbështetin nevojat në rritje dhe shumë të kërkuara për vendin e punës;
- ✓ analizon aftësitë personale në përputhje me kërkesat e një vendi pune.

Detyrat dhe puna e pavarur: Zgjidh një profesion që do të bësh kur të rritesh, mblidh informacionet që do të duhen nga të rriturit si dhe interneti dhe paraqite në një poster atë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Një grupim aftësish		Situata e të nxënit: Aftësitë e mia	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.➤ Kompetenca qytetare: Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon grupimet e profesioneve dhe aftësitë e kërkuara prej tyre.✚ shkruan një CV të thjeshtë.✚ analizon aftësitë e tij dhe sheh si ato përshtaten në një vend pune të caktuar.✚ identifikon aftësitë që mbështesin kërkesat, gjithnjë në rritje, të vendeve të punës.		Fjalët kyçe: Punëmarrës, punëdhënës, profesion, CV, intervistë, kërkesa e lartë, vende pune me rritje të madhe.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve për biznesin, teksti mësimor, modele CV, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvarësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shkrim i shpejtë, Diskutim, Lexo – diskuto, Shkrim i lirë			

Organizimi i orës së mësimi

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1

Nxënësit në një fletë shkruajnë për 2-3' disa aftësi të tyre.

Lexohen nga nxënësit dhe diskutojnë për të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre.

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë.

Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: *A e dini si veprohet kur kërkohet një punë?*

Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2', diskutojnë së bashku dhe sjellin eksperiencat nga prindërit ose familjarët e tyre.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin në hyrje dhe nënvizojnë çfarë nuk kuptojnë. Mësuesja ndihmon nxënësit të kuptojnë informacionin e dhënë duke drejtuar pyetjet për diskutim:

-Çfarë janë punëmarrësit? Po punëdhënësit?

-Çfarë punëtorësh kërkojnë bizneset? Pse?

-Pse qeveria duhet të bëjë kërkime për të përcaktuar se cilat vende pune do të jenë shumë të kërkuara dhe me rritje të madhe në të ardhmen?

-Përse shërben një CV?

-Po intervista e punës?

Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Të kuptojmë konceptet dhe idetë kryesore të mësimi: Duke u mbështetur te informacioni i dhënë në tekst, nxënësit, në mënyrë individuale, shpjegojnë kuptimin e koncepteve kryesore: Punëmarrës, kërkesa e lartë, vende pune me rritje të madhe, CV.

Më pas diskutojnë në çift dhe këmbëjnë idetë me gjithë grupin.

Të zhvillojmë aftësitë e të menduarit: Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe pastaj japin mendimet e tyre duke i argumentuar.

Të zhvillojmë shprehitë e qytetarisë: Paraqitet një CV nga mësuesja dhe diskutohet. Mund të zhvillohet një intervistë me një nga prindërit e nxënësve për të treguar eksperiencat e tyre të punësimit.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 5.

Nxënësit shkruajnë një CV të thjeshtë me të cilën tregojnë se zotërojnë aftësitë e duhura për një punë.

Lexohen dhe diskutohen nga disa nxënës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- identifikon grupimet e profesioneve dhe aftësitë e kërkuara prej tyre.
- shkruan një CV të thjeshtë.
- analizon aftësitë e tij dhe sheh si ato përshtaten në një vend pune të caktuar.
- identifikon aftësitë që mbështesin kërkesat, gjithnjë në rritje, të vendeve të punës.


Detyrat dhe puna e pavarur:

Intervistoni një person të familjes duke u bazuar te pyetjet e tekstit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Ndërlidhjet me botën		Situata e të nxënit: Afër dhe larg	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar.➤ Kompetenca e të nxënit: Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ përshkruan specializimet dhe konkurrencën në biznes.✚ tregon se si specializimet dhe teknologjia kanë dhënë ndihmesën e tyre në sistemin e sipërmarrjes së lirë dhe si ato kanë ndikuar në veprimtarinë ekonomike të botës.✚ shpjegon se si kombet janë të lidhura dhe të kushtëzuara nga njëra-tjetra dhe me ekonominë globale.✚ vlerëson të gjithë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë ekonomike të një kombi, duke i dhënë vendin e duhur secilit prej tyre.✚ përjeton nevojat globale të shumë bizneseve.			Fjalët kyçe: konkurrencë, rivalitet, specializim, online
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Zhvillimi i qëndrueshëm Bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Të nxënit në bashkëpunim, Vija e vlerës			
Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të tregojnë se ku i bëjnë blerjet e tyre. Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë pa u komentuar.			



Hapi 2. Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për blerjet online.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

▪ **Veprimet në situatë**

Hapi 3. Lexohet informacioni në heshtje dhe mbajnë shënime për gjërat e paqarta. Nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Pse themi se teknologjia ka ndryshuar mënyrën sesi punojnë bizneset?
- Për çfarë konkurrojnë bizneset me njëri- tjetrin?
- Çfarë ndodh me një kompani që konkurren në nivel botëror?
- Çfarë është specializimi i një biznesi?

Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Të kuptojmë konceptet dhe idetë kryesore të mësimit: Duke u mbështetur te informacioni i dhënë në tekst, nxënësit , në mënyrë individuale, shpjegojnë kuptimin e koncepteve kryesore: konkurrencë, rivalitet, specializim, online. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe pastaj japin mendimet e tyre duke i argumentuar.

Të zhvillojmë aftësitë e të menduarit: Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup punon me një nga detyrat e mëposhtme:

1. Pse themi që punonjësit shumë të aftë janë forca shtytëse e biznesit?
2. Pse konkurrenca nxit aftësitë krijuese te sipërmarrësit e rinj?
3. Pse sot është e rëndësishme të zotërojmë gjuhë të huaja dhe aftësi të mira komunikimi?
4. Pse sot është e mundur të punësosh një punonjës që banon shumë larg nga vendi i punës? A ishte kjo e mundur shumë kohë më parë?
5. Nëse pjesët e një malli prodhohen në vende të ndryshme, a ndikon kjo në bizneset e tjera që varen nga përdorimi i këtyre pjesëve? Si është ky ndikim?

6. A mund të tregoni me fjalët tuaja si e kuptoni fjalën “ndërvarësi”?

Prezantohet puna e grupeve para klasës.

Të zhvillojmë shprehitë e qytetarisë: Nxënësit shpjegojnë si ka ndikuar zhvillimi i mjeteve të transportit në bizneset e sotme.

▪ **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 5. Nxënëseve u drejtohet pyetja *A na ndihmojnë blerjet online? Pse?*

Ata ndahen në dy grupe (sipas përgjigjes që zgjedhin po ose jo) dhe japin argumentimet e tyre.

Mësuesja i rendit argumentimet e nxënëseve në tabelë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- përshkruan specializimet dhe konkurrencën në biznes.
- tregon se si specializimet dhe teknologjia kanë dhënë ndihmesën e tyre në sistemin e sipërmarrjes së lirë dhe si ato kanë ndikuar në veprimtarinë ekonomike të botës.
- shpjegon se si kombet janë të lidhura dhe të kushtëzuara nga njëra-tjetra dhe me ekonominë globale.
- vlerëson të gjithë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë
- ekonomike të një kombi, duke i dhënë vendin e duhur secilit prej tyre.
- përjeton nevojat globale të shumë bizneseve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pyesni prindërit: Si ndikon gjendja e transportit të prodhimeve bujqësore në tregun e shitjes në zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri? Cilat zona të Shqipërisë e kanë më të vështirë prodhimin e mallrave bujqësore? Pse? Paraqitini përfundimet në formën e një eseje përshkruese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: II	Klasa: IV
Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për biznesin?		Situata e të nxënit: Biznesi ynë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">➤ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.➤ Kompetenca e të menduarit: Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debate.➤ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur➤ Kompetenca personale: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">✚ identifikon faktorët kryesorë për ngritjen e një biznesi.✚ dallon disa nga përparësitë dhe mangësitë e çdo forme të organizimit të biznesit.✚ identifikon tri llojet e organizimit të biznesit.✚ diskuton për teknologjinë, si një burim kapital i kërkuar nga shumica e bizneseve.✚ analizon aftësitë e tij personale në përputhje me kërkesat e një vendi pune.		Fjalët kyçe: Sipërmarrje, mall, shërbim, reklamë, fitim, pronësi, ortak, kërkesë, ofertë, konkurrencë, rivalitet, punëmarrës, punëdhënës.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Matematikë Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Pema e mendimit, Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimi			

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1


Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një, p.sh.:

sipërmarrja	një mënyrë krijuese të menduari dhe aftësi menaxhimi, që janë të nevojshme për të hapur dhe për të vënë në punë një biznes
reklama	mesazh që i nxit njerëzit të blejnë një mall ose shërbim, duke nxjerrë në pah tiparet e tij të veçanta.
fitimi	është sasia e parave që mbetet pasi janë paguar të gjitha shpenzimet e biznesit.
burime njerëzore	janë njerëzit që bëjnë punën që i nevojitet një biznesi

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga kapitulli nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2.

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet nga disa çifte.

- *Veprimet në situatë*

Hapi 3. Punë në grupe:

Nxënësit organizohen në grupe dhe hartojnë planin për ngritjen e një biznesi. Disa sugjerime mund të jenë:

- Biznes për shitjen e lodrave të tyre që nuk i përdorin më.
- Biznes për shitjen e kasetave dhe CD-ve me lojëra, të cilat nuk i përdorin më.
- Biznes për ngritjen e një këndi sportiv për fëmijë.
- Biznes për shitjen e ushqimeve të shëndetshme të përgatitura nga vetë fëmijët, etj.

- *Demonstrim i rezultateve të arritura*

Hapi 4. Prezantohen punët e grupeve

Vlerësimi i situatës: Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- identifikon faktorët kryesorë për ngritjen e një biznesi.
- dallon disa nga përparësitë dhe mangësitë e çdo forme të organizimit të biznesit.
- identifikon tri llojet e organizimit të biznesit.
- diskuton për teknologjinë, si një burim kapital i kërkuar nga shumica e bizneseve.
- analizon aftësitë e tij personale në përputhje me kërkesat e një vendi pune.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Listoni disa nga bizneset e suksesshme në komunitetin tuaj.

